



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në: “Mësuesi për Arsimin e Mesëm” me profile:

- a. **Gjuhët dhe Komunikimi;**
- b. **Shkencat e Natyrës;**
- c. **Matematikë;**
- d. **Shoqëria dhe Mjedisi;**
- e. **Teknologjia dhe Tik;**
- f. **Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti;**
- g. **Arte;**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Marjana SINANI

Dr. Leticja GUSHO

Janar / 2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TË PROGRAMIT

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, me profile: a) Gjuhët dhe Komunikimi, b). Shkencat e Natyrës, c) Matematikë, d) Shoqëria dhe Mjedisi, e) Teknologjia dhe Tik, f) Edukimi Fizik, Sportet dhe Shëndeti, g) Arte, kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, “Universiteti European i Tiranës”, është realizuar procesi respektiv i vlerësimit respektivisht sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Institucioni i Arsimit të Lartë, jopublik, “Universiteti European i Tiranës”, është krijuar me Vendimin Nr.636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti European i Tiranës” si dhe të programeve të Studimit të Ciklit të Parë”.

UET është akredituar si institucion i arsimit të lartë, me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.246, datë 24.07.2009. Me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.90, datë 28.02.2017 është miratuar Statuti në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr.08, datë 03.11.2016 të Universitetit). Gjithashtu, “Universiteti European i Tiranës” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.12, datë 07.04.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.

Sot Universiteti European i Tiranës ka në përbërjen e tij pesë fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale me:

- Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit;
- Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve;
- Departamenti i Arteve të Aplikuara;

2. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe MN me:

- Departamenti i Shkencave Juridike;
- Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara;
- Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor;

3. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit me:

- Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;
- Departamenti Menaxhimit dhe Marketingut;
- Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm;

4. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës me:

- Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë;
- Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;
- Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin;

5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore-Teknike me:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;
- Departamenti i Imazherisë;
- Qendra e Kërkimeve Shkencore në Shëndet Publik;

Ky universitet boton disa revista shkencore, ku mund të përmenden: *Educatio, Jus & Justicia, Polis, Economicus, Medicus*. UET në përputhje me Ligjin Nr.80/2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", ofron studime me kohë të plotë në tre ciklet e studimit; Bachelor, Master (MP dhe Msc), si edhe Doktoraturë.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë Master i Shkencave, në: "Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile" i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, fillimisht i themeluar si Departamenti i Edukimit në vitin akademik 2010-2011. Ky departament është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Programet e studimit të ciklit të dytë janë hapur duke u bazuar në VKM nr.74, datë 21.01.2009, "Për hapjen e programeve të Ciklit të Dytë".

Ky program është licencuar fillimisht me Urdhër nr.408 datë 22.08.2011, i ndryshuar me Urdhër nr.45 datë 09.02.2012 si program Master i Shkencave në Shkencat e Edukimit me dy profile: Politikat e Edukimit dhe Administrim Shkollor, ofruar nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe i Edukimit. Programi u akreditua me Urdhër të Ministrit Nr.251 datë 14.06.2013. Duke u mbështetur në hapësirën ligjore të krijuar me ndryshimet në legjislacionin e ri për arsimin e lartë, të rrjedhura nga Ligji Nr 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, për vitin akademik 2018-2019, ky program studimi ofrohet i përshtatur dhe me emërtimin e ri, Msc në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm", me profile: a. Gjuhët dhe Komunikimi, b. Shkencat e Natyrës, c. Matematikë, d. Shoqëria dhe Mjedisi, e. Teknologjia dhe TIK, f. Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti, g. Arte, në përputhje me vendimin e Senatit Akademik Nr.7 të UET, datë 14.06.2018, dhe konfirmuar me shkresën e MASR me Nr.8244/2 prot, datë 12.09.2018.

Ky program master përmban gjithsej 120 ECTS dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë master ndër vite ka qenë:

- Për vitin akademik 2019-2020 është 26 studentë;
- Për vitin akademik 2018-2019 është 24 studentë;
- Për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 5 studentë;
- Për vitin akademik 2016-2017 ka qënë 4 studentë;
- Për vitin akademik 2015-2016 ka qënë 11 studentë;
- Për vitin akademik 2014-2015 ka qënë 26 studentë;
- Për vitin akademik 2013-2014 ka qënë 10 studentë;

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi Master i Shkencave në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile" është akredituar për herë të parë në vitin 2013, bazuar në Urdhërin Nr. 251, datë 14.06.2013 mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 467, datë 03.05.2013.

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- Përfshirjen e studentëve në veprimtari me fokus “kërkime shkencore”;
- Identifikimi dhe kontraktimi i institucioneve prestigjioze ku mund të bëhet praktika e studentëve, si IZHA, IKT, MASH QKT etj;
- Pasurimi i bibliotekës me “tituj” të mirnjohur në shkencat e dukimit në nivel evropian e përtej që do të jenë bazë teorike për të bërë hulumtime në shkencat e edukimit;
- Përfshirjen e studentëve në institucione vendimarrëse si : Këshilli i Etikës, Senati Akademik etj;
- Të sigurohet që studentët e këtij program studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Referuar dokumentacionit të ardhur nga institucioni si dhe vizitës në institucion konform agjendës e konfirmojmë se, **janë përmbushur plotësisht pesë rekomandimet** e lëna nga akreditimi i vitit 2013.

Rekomandimi 1. *Te realizohet përfshirja e studenteve në veprimtari me fokus “kërkimor e shkencor”.*

Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni¹ rezulton që studentët e përfshirë në këtë program janë të angazhuar në veprimtari kërkimore dhe shkencore. Institucioni kryen veprimtari me fokus shkencor ku angazhohen dhe studentët. Kështu në Veprimtarinë periodike vjetore “Ditët e Studimeve Shqiptare”, ka aktivitete ku studentët të këtij programi janë të angazhuar.

Rekomandimi 1 është përmbushur plotësisht

Rekomandimi 2 *Identifikimi dhe kontraktimi i institucioneve prestigjioze ku mund të bëhet praktika profesionale e studentëve si IZH-a, IKT, MASH, QVA, e tjera.*

Na rezulton të ketë marrëveshje bashkëpunimi² me institucionet e lartpërmendura por nuk identifikua as një emër studenti që të ketë përmbushur praktikën profesionale në njërin nga institucionet e lartpërmendura, pasi Institucioni ka riorganizuar programin e ciklit të dytë nga MSc. në Shkencat e Edukimit, në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm me Shtatë Profile.

Rekomandimi 2 del jashtë kuadrit aktual të këtij programi studimi.

¹ UET. “Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë”, ASCAL. Dok. nr.30.18. Parë në Nëntor 2019, gjendet në:

Sistemin AMS te ASCAL, UET. “Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020”, ASCAL. Dok. nr.6.3.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL,

² UET. “Marrëveshjet e bashkëpunimit ; Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale”, ASCAL. Dok. nr.93.32.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL,

Rekomandimi 3 Pasurimi i bibliotekës me “tituj” të mirënjohur në fushat e shkencave të edukimit, në nivel europian dhe më tej, që do të jenë bazë teorike për hulumtimin në shkencat e edukimit.

Ky rekomandim na rezulton i përmbushur pasi biblioteka kishte mjaftueshmërisht tituj të shtuar {rreth 199 tituj gjithsej} dhe literaturë të përditësuar në 5 vitet e fundit, në fushat e edukimit, referuar vitit 2013.

Rekomandimi 3 është përmbushur plotësisht

Rekomandimi 4 Përfshirja e studentëve në institucionet vendimarrëse si Këshilli i Etikës, Senati Akademik e tjera.

Na rezulton që studentët përfaqësohen³ në vendimarrje në të gjitha format e mundëshme, qoftë si anëtarë të përhershëm apo si anëtarë në grupe “Ad-hok” që ngrihen për çështje të ndryshme. Ky rekomandim na rezulton i përmbushur.

Rekomandimi 4 është përmbushur plotësisht

Rekomandimi 5 Të sigurohet që studentët e këtij programi të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Na rezulton që studentët e kanë kriter ligjor hyrjeje në ndjekje të këtij programi gjuhën e huaj, të dëshmuar nga institucioni ku e kanë vërtetuar nivelin e gjuhës.

Rekomandimi 5 është përmbushur plotësisht

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr.531, datë 11.09.2018, për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile”.

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UET, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Mariana Sinani, dhe Dr. Leticja Gusho. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli

Dokumentacioni ligjor mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur vlerësimi i jashtëm është:

³ UET. “Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC”, ASCAL. Dok. nr.101.30. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

- Ligji nr.80 datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr.636, datë 20.09.2006, “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti European i Tiranës” si dhe të programeve të Studimit të Ciklit të Parë”.
- Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës (Sot Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), për licensimin e programit të studimit të ciklit të dytë bazuar në VKM nr.74, datë 21.01.2009, “Për hapjen e programeve të Ciklit të Dytë, në Shkollën e Lartë Universitare Private “Universiteti European i Tiranës”.
- VKM nr.531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.
- Rregullore e sigurimit të cilësisë e ASCAL

Aktivitet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë kryer disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

- **Analiza e të dhënave parësore.** Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm” (2019) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm (Urdhër i Rektorit, nr.3, datë 04.03.2019), Statuti i UET, Rregullore e UET, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, paketa e plotë e dokumentacionit të Programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit.
- **Analiza e të dhënave dytësore.** Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga vizitat në institucion. Vizitat në ambjentet e institucionit UET u zhvilluan në datat 4, 5, dhe 6 Nëntor 2019. Gjatë këtyre vizitave u zhvilluan bashkëbisedime të qëllimta si edhe vëzhgime të ndryshme. Kështu, u realizuan biseda të drejtuara me Drejtuesin e Njësisë Qëndrore, Dekanan e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, Përgjegjës të Departamentit të Psikologjisë, Edukim dhe Sporte, takim me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, takim me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, takim me përfaqësues të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, takim me përfaqësues të sekretarisë, takim me përfaqësues të Grupit të Vetëvlerësimit të Programit, takim me stafin akademik të programit të studimit, si edhe takim dhe intervista me studentë të ndryshëm.
- **Vëzhgim i mjediseve**
Gjatë ditëve të vizitave në institucion u realizuan vëzhgime të auditorëve, të laboratorëve të informatikës, si edhe ambjenteve të bibliotekës.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.12.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 86/55 Prot, datë 23.12.2019. Universiteti Europian i Tiranës përcjell pranë ASCAL më datë 08.01.2020, nëpërmjet shkresës me Nr. 32/23 Prot, datë 08.01.2020, përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi për arsimin e mesëm” me 7 Profile

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit në fjalë nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kombëtare duke përgatitur mësues të arsimit të mesëm që do të punojnë për këtë drejtim. Programi i studimit synon nxitjen dhe respektimin e vlerave kombëtare, në përputhje të plotë edhe me filozofinë e përzgjedhur nga UET, sipas të cilit arsimi i lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi dhe ku universitetet duhet të jenë në vijën e parë të respektimit të kodeve të sjelljes së mirë në të gjitha fushat ⁴ .
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi në fjalë, mbështetet në misionin kryesor të UET, që reflekton edhe filozofinë e këtij institucioni për të përcjellë një edukim cilësor, me anë të gërshetimit të një kërkimi shkencor të vlefshëm, që të jetë në funksion të nevojave dhe të dijes së shoqërisë shqiptare. Në këtë kuadër, të gjitha silabuset lëndore pasqyrojnë vlerat kombëtare, bashkëveprimin e kulturës sonë me atë botërore, etj. Kjo konfirmohet edhe nga Statuti i UET ⁵ , ku misioni kryesor i tij është t’u japë studentëve një edukim cilësor, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira

⁴ UET. “Plani Strategjik 2015-2020, Vizioni, pika 9”, ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁵ UET. “Statuti UET, Neni 6”, ASCAL. Dok. nr.4.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

	të shkencës, si edhe partneriteteve me aktorët kombëtarë të tregut të punës ⁶ .								
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Master i Shkencave, në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile” është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimin e këtij universiteti që është: -Të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare; -Një qëndër ekselence në formimin akademik të studentëve; -Një qëndër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike, ekonomike, juridike, të edukimit e të teknologjisë së informacionit në vend, me ndikim në rajon dhe më gjërë; ⁷ .								
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga paketa e dokumentacionit e ofruar nga UET, rezulton se program i studimit “Master i Shkencave” në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile” është i hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik në vend, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel kombëtar.								
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Referuar rregullores së programit të studimit, ky program synon ta pajisë studentin me baza të njohurive kërkimore për tu mundësuar atyre vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve ⁸ .								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshatje dhe në zbatim të	Programi studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile” është hartuar në përputhje të plotë me misionin, qëllimet dhe planin strategjik të UET. Ky

⁶ UET. “Plani Strategjik 2015-2020”, Vizioni, pika 4”, ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁷ UET. “Plani Strategjik 2015-2020, Vizioni, pika 9”, ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁸ UET. “Rregullorja e programit të studimit, pika 3.3”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>program ofron studimet për mësues për ciklin e mesëm të ulët dhe për ciklin e mesëm të lartë, (<i>program ambicioz nëse referohemi faktit që programi tenton mbulimin e dy cikleve, AMU dhe AML</i>). Programi, gjithsesi, është konform objektivave strategjikë të zhvillimit të Institucionit.⁹</p>			
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Institucioni UET ka të miratuar statutin dhe rregulloren në përputhje me ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si edhe me dokumenta të tjerë themeltarë të institucionit. Në këto dokumenta janë të përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike dhe sociale, të edukimit, si edhe është hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike dhe shkencore¹⁰ etj.</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi, organizimi, si edhe përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile” është në përputhje me fushën akademike në të cilën vepron Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve. Gjithashtu, ky program i ciklit të dytë është i organizuar në përputhje me atë se çfarë parashikon ligji i Arsimit të Lartë nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet ligjore dhe nënligjore të rrjedhura prej tij¹¹.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, shtrirë në 7 profile, është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, duke ju përgjigjur përgjithësisht ndryshimeve socio-ekonomike dhe zhvillimeve që dikton tregu i punës¹².</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

⁹ UET. “Statuti UET, Neni 6”, ASCAL. Dok. nr.4.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁰ UET. “Plani Strategjik 2015-2020, Objektivat Strategjike, pika 3”, ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹ UET. VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”

¹² UET. “Plani Strategjik UET 2015-2020. Prioritetet në Procesin Mësimor, pika 4”, ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, me profile, ka objektiva të qartë për formimin e studentëve veçanërisht në aspektin pedagogjik¹³, duke e konsideruar të mjaftueshëm formimin shkencor që ata kanë marrë në studimet Bachelor sipas profileve përkatëse.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Siç vërtetohet edhe nga RVB-ja e programit të studimit¹⁴, para hapjes së programit të studimit, institucioni nuk ka kryer studim të tregut të punës, pasi kjo nuk ka qënë kërkesë e legjislacionit në fuqi. Në vazhdim, institucioni ka ngritur mekanizmat e veta për të njohur tregun e punës, ku në to bëjnë pjesë konsultimet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel departamenti. Nga ky instrument mblidhen të dhëna në mënyrë periodike, për të konsultuar përputhshmërinë e përmbajtjes së programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, si edhe për të analizuar ecurinë e zhvillimit të praktikave dhe veprimtarive të tjera.</p> <p>Gjatë aplikimit të programit, Departamenti ka kryer studime të tregut të punës, por në to duhet të jepet më qartë metodologjia dhe instrumentat e përdorur për mbledhjen e të dhënave.¹⁵</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathësisive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe</p>	<p>Gjatë strukturës të programit të studimit “Master i Shkencave”, me profile, objektivat formues, struktura, si edhe përmbajtja e studimit garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathësisive dhe kompetencave të cilat synojnë të formojnë mësues të arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit</p>

¹³ UET. “Rregullore e programit të studimit MSH, Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴ UET. “RVB, Master i Shkencave, Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, ASCAL. Dok. nr.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁵ UET. “Studimi periodik i tregut të punës”, ASCAL. Dok. nr.29.17. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>të mesëm të lartë të pajisur kryesisht me kompetencat pedagogjike¹⁶. Sugjerohet që t'i lihet një hapësirë me më shumë se 18 kredite¹⁷ formimit shkencor të studentëve në profilet Gjuhë dhe Komunikim, Shkenca të Natyrës, Matematika, Shoqëria dhe Mjedis, Teknologjia dhe TIK, Edukimi Fizik, Sportet dhe Shëndeti, si edhe Arte.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit për afrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar duke pasqyruar përvojat e programeve të studimit të institucioneve të ngjashme të huaja, sidomos ato italiane.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikave të mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me gjithë legjislacionin në fuqi, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian, si edhe duke u mbështetur në një përvojë 10 vjeçare të ofrimit nga ky institucion të programeve të cilat mbulojnë fushën e edukimit.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i paketës të dokumentacionit të marrë nga vizita në institucion, ku është i përfshirë edhe plani mësimor i programit¹⁸, vihet re që praktika profesionale ka vendin e saj në këtë program. Gjithashtu, edhe nga takimet me studentët në institucion u konstatua që praktika e kryer përgjithësisht përputhej me objektivat dhe qëllimet e programit dhe gjithashtu edhe me direktivat për profesionin e rregulluar të mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e</p>	<p>Aktualisht, programi i studimit është i licensuar në Gjuhën Shqipe, dhe nuk ofron ndonjë lëndë në gjuhë të huaj, por ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të huaja për shkëmbimin e stafit dhe të studentëve. Ka iniciativa mjaft të mira për mobilitetin e studentëve në rang departamenti, por nuk ka të dhëna për thithjen e studentëve të huaj në këtë program studimi¹⁹.</p>

¹⁶ UET. “Paketa e silabuseve lëndore për Master Shkencor”, ASCAL. Dok. nr.31-64. Parë në Nëntor 2019.

¹⁷ UET. “Plani mësimor i programit”, ASCAL. Dok. nr.178.14.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁸ Ibid

¹⁹ UET. “Plani Strategjik 2015-2020, Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar, pika 3”, ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

institucionit.				
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Përveç hartimit të programit të lëndës në gjuhën shqipe, një version i shkurtuar hartohet dhe në gjuhën Angleze. Këto dokumenta janë të aksesueshëm për stafin në rrjetin Intranet. I gjithë dokumentacioni arkivohet në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>UET është një institucion me eksperiencë mbi 13 vite, (sipas VKM Nr. 636, datë 20.9.2006²⁰) që ka krijuar një traditë në trajnim të stafit me përvojë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Edhe Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale që ofron këtë program studimi, ka një eksperiencë 13 vjecare, (ish Fakulteti i Shkencave Sociale, sipas VKM Nr.636, datë 20.09.2006).</p> <p>Evidencat e dorëzuara dëshmojnë për cilësi të stafit akademik të brendshëm e të jashtëm të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit.²¹ Konstatohet se Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale për vitin akademik 2018-2019 ka gjithsej 73 pedagogë, nga të cilët 37 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku 6 kanë titullin “Profesor”, 7 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 13 kanë gradën Dr./PhD, si edhe 11 janë Asistent Lektorë me Msc; dhe 36 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 4 kanë titullin “Profesor”, 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 14 kanë gradën Dr./PhD. dhe 14 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Në mënyrë specifike, nga shqyrtimi i organogramës të dorëzuar nga Institucioni, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale ka në përbërjen e tij tre departamente:</p>

²⁰ “VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, “Universiteti European i Tiranës”.

²¹ UET. “Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit” ASCAL. Dok. nr.51.23. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS të ASCAL.

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dep i Shkencave Humane dhe Komunikimit, ka në përbërjen e tij 16 PAE nga ku 12 me tituj/grada; 2. Dep i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, ka në përbërjen e tij 12 PAE nga ku 7 me tituj/grada; 3. Dep i Arteve të Aplikuara, ka në përbërjen e tij 9 PAE nga ku 7 me tituj/grada; <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit, për vitin akademik 2018-2019, rezultojnë të jenë të angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi gjithsej 17 staf akademik, nga ku 12 jane staf efektiv (PAE), nga të cilët 3 Prof.Dr, 4 Prof.Asoc.Dr, 3 me gradën Dr/PhD, dhe 2 asistente-lektore me Msc, si dhe 5 staf akademik me kontratë (PAK), nga të cilët 4 me gradën Dr dhe 1 lektor me MND.</p> <p>Raporti që del nga të dhënat e dokumentacionit për PAE/PAK është 70/30.</p> <p>Raporti pedagog/student në nivel njësie bazë është 1 me 28.</p> <p>Departamenti është i organizuar në grupe mësimore, që drejtohen nga përgjegjësit e grupeve mësimore²².</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fakulteti që ofron këtë program studimi, për të qënë në kohezion edhe me fushat e studimit që mbulon si Komunikimi, Filozofia, Historia, Gjuhësia, Letërsia, Psikologjia, Mësuesia, Sportet dhe Edukimi Fizik, si dhe Artet, ka ndryshuar emrin nga Fakulteti i Shkencave Sociale, në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.</p> <p>Me emërtimin e ri, ka një mbulim më të plotë të të gjitha fushave të përgjithshme të studimit që ky fakultet mbulon.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve. Fusha kërkimore dhe akademike e kësaj njësie bazë rezulton të jetë në koherencë me programin e studimit sipas klasifikimit të këtij të fundit.²³</p>

²² UET. "Dokumenti F.IV-F.V: Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit", ASCAL. Dok. nr.9.6. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

²³ UET. "Të dhëna për numrin e programeve të ofruara nga departamenti", ASCAL. Dok. nr.84.26. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësie e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni zotëron rregullore dhe akte të tjera të nxjerra prej tij ku përcaktohen me saktësi si ndarja e detyrave ashtu edhe përgjegjësia për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit. Këtu peshën kryesore në ndarjen e volumit të detyrave dhe të përgjegjësive e zë njësie bazë përgjegjëse për programin e studimit. Roli i drejtuesit të njësisë bazë, të titullarit të një lënde specifike, roli i përgjegjësit të grupit mësimor/koordinatorit të programit ²⁴ përcaktohen në mënyrë të qartë në aktet rregullatore. ²⁵
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, institucioni ka 95 marrëveshje (memorandume bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi, si edhe Kinë. ²⁶ UET gjithashtu ka marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare, publike dhe jopublike. <i>Nuk identifikua marrëveshje specifike që potencojnë programin në fjalë.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Megjithëse janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, gjithmonë duke synuar bashkëpunime dypalëshe / shumëpalëshe midis shoqatave studentore të universiteteve analoge në rajon, vendet e BE, por edhe më gjerë, ²⁷ <i>nuk konstatojmë raste konkrete ku studentet e programit në fjalë të jenë përfitues të marrëveshjeve dy palëshe.</i>

²⁴ UET. “Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 16, 17, 18, 21, 22”, ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “Dokumenti F.IV-F.V: Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit”, ASCAL. Dok. nr.9.6. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

²⁵ UET. “Vendim për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit”, ASCAL. Dok. nr.96.36. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

²⁶ UET. <http://uet.edu.al/ne/partnere/>

²⁷ UET. “Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UET”, ASCAL. Dok. nr.98.34. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në paketën që institucioni ka paraqitur, ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale. Ndër këto dokumenta, është edhe akti i brendshëm rregulator për zhvillimin e praktikave profesionale. Në këtë dokument parashikohen procedurat që duhet të ndiqen, si edhe roli i aktorëve kryesorë dhe njërive të ndryshme të përfshira në këtë proces.²⁸</p> <p>Megjithatë, nga dokumentacioni si edhe nga bisedat me studentët, rezulton se përmbushja e praktikave profesionale të studentëve në institucione si : <i>Kopështi “Lulet e jetës” nuk e justifikon praktikën profesionale të një studenti që diplomohet në ciklin AMU apo ciklin AML me profil mësuesi në matematikë/shkenca sociale e tjera.</i></p> <p><i>Në këtë këndvështrim, praktika profesionale mbetet një nga çështjet që lipset të trajtohet me kujdes.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me universitete të tjera, por përse i përket programit të studimit “Mësuesi në Arsimin e Mesëm”, me profile, <i>nuk u konstatua realizimi i kërkimeve shkencore të mirëfillta dhe mobiliteti i studentëve të këtij programi.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve harton raporte analitike vlerësuese periodike²⁹, për përfitimet e studentëve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Në përgjithësi kjo realizohet për fokusin e praktikave profesionale. Nuk konstatohen te tilla raporte analitike, referuar programit në fjalë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.6</p>	
<p>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për</p>	<p>Institucioni UET kishte funksionale strategjinë e kërkimit shkencor³⁰, dhe, gjithashtu, nga vizita në Bibliotekën e</p>

²⁸ UET. “Lista e institucioneve bashkëpunuese për praktikën profesionale”, ASCAL. Dok. nr.91.32. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

²⁹ UET. “Raport periodik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit”, ASCAL. Dok. nr.97.35. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

³⁰ UET. “Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017-2020, UET Vizioni, pika 14”, ASCAL. Dok. nr.6.3.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Institucionit u konstatua që botoheshin disa revista shkencore, ku mund të përmenden: <i>Educatio, Jus & Justicia, Polis, Economicus, Medicus.</i>			
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Në organikën e UET është i përcaktuar pozicioni i zv/Rektorit për kërkimin shkencor, që ka në përgjegjësi pjesën e kërkimit shkencor dhe studimet e ciklit të tretë.			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni UET, ka një politikë monitoruese, ku çdo dy vjet realizohet një follow up me stafin akademik mbi publikimet dhe aktivitetin e tyre shkencor. ³¹			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Në kodin e etikës së institucionit janë përcaktuar kriteret kryesore të cilat duhet të ndiqen nga çdo anëtar i komunitetit të UET, për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. ³²			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Programi i studimit ka të përfshirë në kurrikulën e tij ³³ , lëndë të formimit shkencor të cilat kontribuojnë në ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet

³¹ UET. "Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020, pika 5.2", ASCAL. Dok. nr.6.3.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. "Formati G.1.12.1 Formular për vetëvlerësimin e performancës së personelit akademik", ASCAL. Dok. nr.127.41. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

UET. "Dokumenti A.II. Kodi i Etikës, pika A.II.7.1 dhe A.II.7.2", ASCAL. Dok. nr.174.57. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

³² UET. "Dokumenti A.II. Kodi i Etikës, pika A.II.7.1 dhe A.II.7.2", ASCAL. Dok. nr.174.57. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

³³ UET. "Dokumenti A.II. Kodi i Etikës, pika A.II.7.1 dhe A.II.7.2", ASCAL. Dok. nr.174.57. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

nënljigjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga Kurrikula e Programit³⁴ Master i Shkencave “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, me profile, konstatohet se të gjitha lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 6 kredite ndërsa provimi i përgjithshëm/diploma është e vlerësuar me 12 kredite.</p> <p>Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që ky program studimi është me kohëzgjatje 2 vite akademike, 120 ECTS, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Grumbullimit dhe të Transferimit të Krediteve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Në objektivat e programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, me profile, është përcaktuar që ky program synon formimin e shprehive të veçanta dhe kompetencave bazë, specifike të transferueshme, si një përvojë dhe garanci për tregun e punës për të cilën përgatiten këta studentë.</p> <p>Siç konstatohet edhe nga vetë kurrikula e programit të studimit, qëllimi kryesor është në përgatitjen e mësuesve me formimin kryesisht pedagogjik.³⁵</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Ky program synon ta pajisë studentin me koncepte të aplikuara, t’i sigurojë një përgatitje për profesionin e rregulluar ose për marrjen e licencës; t’i sigurojë aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës; t’i sigurojë mundësi për internship në operatorët kryesorë të tregut të punës; aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës dhe ta pajisë atë me një diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një produkti profesional.³⁶</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi u jep studentëve njohuri të thelluara teorike dhe praktike si edhe përgatitje për kërkimin e pavarur. <i>Konstatohet se diferencimi vetëm me tre lëndë, për mbulimin e secilit nga shtatë profile, në arsyetimin tonë është i pakët për mirëorientimin e studentëve në specialitetin që ata kanë zgjedhur dhe për përfitimin e shprehive përkatëse të nënfushave specifike, si janë gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, matematika, shoqëria dhe mjedisi, teknologjia dhe TIK, edukimi fizik, sportet dhe shëndeti, dhe Artet.</i></p>

³⁴ UET. “Kurrikula e programit MSH Mësuesi për Arsimin e Mesëm, me profile”, ASCAL. Dok. nr.24.14. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

³⁵ UET. “Rregullorja e programit të studimit, Mësuesi për Arsimin e Mesëm, me 7 profile”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

³⁶ Ibid

<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Program i studimit është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (neni75)³⁷. Ky program studimi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Studimet përmbillen me punim diplome.</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët në përmbajtjen e kurrikulës janë të organizuar sipas kategorive (A-E), me peshën specifike të përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM-së nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e e programeve të studimit të ofruara nga IAL.”³⁸ Studenti merr 12 kredite në kategorinë A, 60 kredite në kategorinë B, 18 kredite në kategorinë C, 12 kredite në kategorinë D, dhe 18 kredite në kategorinë përmblylëse E³⁹.</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar në Institucion, konstatohet që punimi i diplomës ndodhet në kategorinë E, “Detyrime Përmblylëse” dhe ka 18 ECTS. Gjithashtu, në dokumentacionin përkatës janë të përcaktuara qartë procedurat e zhvillimit të diplomës⁴⁰.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve dhe përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike⁴¹. Ky fakultet përbëhet nga tre departamente:</p>

³⁷ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 75

³⁸ VKM Nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”

³⁹ Ibid

⁴⁰ UET. “Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”, ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁴¹ UET. “Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2”, ASCAL. Dok. nr.9.6. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

akademike.	<ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, i cili ka 16 PAE, nga të cilët 12 me grada/tituj; - Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, i cili ka 12 PAE, nga të cilët 7 me grada/tituj; - Departamenti i Arteve të Aplikuara, i cili ka 9 PAE, nga të cilët 7 me grada/tituj.
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Programi ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, i cili është themeluar si Departament i Edukimit në vitin 2010-2011.</p> <p>Për vitin aktual 2019-2020, departamenti ka në përbërje gjithsej 18 personel akademik nga ku 10 personel akademik efektiv (PAE), nga ku 5 me grada/tituj, dhe 8 personel akademik me kontrate (PAK), nga ku 6 me grada/tituj.</p> <p>Në vitet e mëparshme akademike raportet PAE/PAK të departamentit përgjegjës për programin e studimit kanë qënë:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (12 / 9), nga këta me grada/tituj shkencore 7 / 7;</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018, (19 / 6), nga këta me grada/tituj shkencore 12 / 3;</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017, (20 / 2) nga këta me grada/tituj shkencore 11 / 1;</p> <p>Për vitin akademik 2015-2016, (16 / 5) nga këta me grada shkencore 9 / 2;</p> <p>Për vitin akademik 2014-2015, (9 / 9) nga këta me grada shkencore 5 / 2;</p> <p>Për vitin akademik 2013-2014, (8 / 11) nga këta me grada shkencore 5 / 4;</p> <p>Raporti Pedagog/student në nivel njësie bazë është 1 me 28.</p> <p>Departamenti është i organizuar në grupe mësimore, që drejtohen nga përgjegjësit e grupeve mësimore.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për ofrimin e këtij program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion rregullator, ku është e përcaktuar që departamenti, në funksionin e njësisë bazë, ngarkon edhe një pedagog, i caktuar në rolin e këshilluesit të karrierës, që mbikqyr studentët gjatë zhvillimit të praktikave</p>

klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	profesionale në institucione/organizata apo kompani të ndryshme. ⁴²			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Koordinatori për Programin e Studimit Master Shkencor në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm” me profile, është Prof. Asoc. Dr. Tomi Treska. Koordinatori i programit është përgjegjës për ecurinë e programit dhe informon në mënyrë periodike Përgjegjësin e Departamentit. ⁴³			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Konfirmuar edhe nga takimet e zhvilluara në institucion, Koordinator i Programit ndjek me prioritet zhvillimin e orëve mësimore, kontrollon silabuset, firmos tezat. Koordinatori raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë te drejtuesi i departamentit ose gjatë mbledhjeve të departamentit. ⁴⁴			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Dokumentet UET kanë të publikuara gjithë informacionin që lidhet me organizimin, strukturën, si edhe përmbajtjen e programit të studimit. Çdo anëtar i personelit akademik dhe jo vetëm, ka mundësi të njihet jo vetëm me Rregulloren dhe Statutin e universitetit, por edhe me kurrikulën, planet mësimore, silabuset, si edhe me çdo aktivitetet tjetër që rregullon jetën e brendshme të UET. Për çdo program studimi, studentët marrin çdo informacion të mundshëm në lidhje me programin e studimit, me lëndët, si edhe për modulet e tij. Gjithashtu, në sistemin LMS ⁴⁵ si edhe në internet pasqyrohen silabuset dhe materialet e leximit.
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në	Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, çdo program i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete

⁴² UET. “Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale”, ASCAL. Dok. nr.93.32.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁴³ UET. “Vendimi për emërimin e Koordinatorit”, ASCAL. Dok. nr.96.36. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁴⁴ UET. “Dokumenti F.IV-FV. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit”, ASCAL. Dok. nr.9.6. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁴⁵ UET. “Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS”, ASCAL. Dok. nr.146.46.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	formuese, të dhëna që detajohen në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit. ⁴⁶
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Kohështrirja e Programit Master i Shkencave në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm me 7 profile" është dy vite akademike me nga dy semestra secili vit ku secili semestër është nga 15 javë. Studenti në përfundim merr 120 kredite ECTS. ⁴⁷
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Rregullorja e UET si edhe rregullorja e çdo programi studimi përcakton nivelin e frekuentimit (80%) për rastet e programeve të ciklit të dytë, si edhe mënyrën dhe sistemin e vlerësimit të dijeve. ⁴⁸ Plani mësimor i programit jep çdo lloj informacioni në lidhje me ndarjen e lëndës në semestra, ngarkesën mësimore si edhe orët e punës individuale për çdo lëndë.
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e programit të studimit si edhe në dokumentet e tjera rregullatore të UET përcaktohen me hollësi kriteret e transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve si edhe proceset që lidhen me to. ⁴⁹
Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (silabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Silabuset miratohen në fillim të semestrit nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe drejtuesi i departamentit dhe hartohen sipas udhëzimeve specifike. ⁵⁰ Silabuset e lëndëve në përfshirje të kurrikulës strukturohen sipas formatit të miratuar në nivel institucioni, ku në to paraqiten objektivat e lëndës, temat për çdo javë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, si edhe literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik	Rregullorja e programit të studimit, në pikën 10 të saj, parashikon rishikimin periodik të programit të studimit, planit mësimor, disiplinave mësimore, si edhe të krediteve

⁴⁶ UET. "Kurrikula e programit", ASCAL. Dok. nr.24.14. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁴⁷ UET. "Plani mësimor i programit", ASCAL. Dok. nr.178.14.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁴⁸ UET. "Rregullorja e programit, pika 3", ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

UET. "Plani mësimor i programit", ASCAL. Dok. nr.178.14.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁴⁹ UET. "Rregullorja e programit të studimit, pikat 2 dhe 9", ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. "Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve", ASCAL. Dok. nr.88.28. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁵⁰ UET. "Formati për hartimin e syllabusit", ASCAL. Dok. nr.31.19.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	për secilën prej tyre, bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe dinamikat e tij. ⁵¹ Silabuset e përditësuara miratohen përpara fillimit të çdo semestri.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi është në përputhje të plotë me nenin 75, pika 6 të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁵² . Në bazë të kësaj pike përcaktohet se programet Master Shkencor organizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja e tyre është dy vite akademike. Ky program studimi është me 120 kredite dhe me një kohëzgjatje 2 vite akademike.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Organizimi i programit është realizuar që të ketë një balancim midis formimit teorik dhe atij praktik, për arritjen e rezultateve të të nxënit, njohurive teorike bazë të profilit të studimit me qëllim punësimin e studentëve. <i>Duhet të theksohet se ofrimi i këtij masteri me 7 profile të cilat më pas diferencohen vetëm në 3 lëndë ose vetëm në 18 kredite, të mbuluar në mënyrë jo të plotë formimin e shprehive të veçanta të thelluara në specialitetet që ata kanë.</i>
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi ka një shpërndarje të studuar të ngarkesës në 4 semestra akademike, duke mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit. ⁵³ GVJ konstaton se në vitin e parë të programit zhvillohen 10 lëndë gjithsej. Gjashtë lëndë zhvillohen në vitin e dytë. Gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë zhvillohet edhe praktika mësimore. Ndërsa Punimi i Diplomës fillon të

⁵¹ UET. “Rregullorja e programit të studimit”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁵² Ligji nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 75, pika 6.

⁵³ UET. “Plani mësimor i programit”, ASCAL. Dok. nr.178.14.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

	<p>trajtohet që në semestrin e parë të vitit të dytë (10 orë në auditor) e vazhdon në semestrin e dytë të vitit të dytë (14 orë në auditor). Shpërndarja e ngarkesës mësimore në katër semestrat është e balancuar dhe lë hapësira për kombinimin e duhur teoriko-praktik.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit është e qartë dhe e mirëpërcaktuar⁵⁴. Lëndët e programit janë të ekuivalentuara në kredite sipas sistemit evropian të Krediteve ECTS, duke iu përshtatur dhe Sistemit të Bolonjës⁵⁵</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi ofron një ndërthurje të elementëve praktikë dhe teorikë. U konstatua se parimi themelor i ndërtimit të programeve lëndore është parimi i rrathëve, ku 70% e zënë njohuritë bazë themelore, 15% njohuri të thelluara dhe të aplikuara, si edhe 15% kritikë e teorisë dhe aplikimeve të fushës⁵⁶. Ky organizim ka për qëllim të lehtësojë përshtatjen e studentëve të cilët vijnë nga programe të tjera studimi, brenda ose jashtë UET, duke lehtësuar sa më shumë procesin për studentët. Pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve, studentët kanë mundësi të regjistrohen në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, pas kryerjes së praktikës profesionale për një periudhë 1 vjeçare.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si edhe nga bisedat e realizuara nga vizita në institucion, u konstatua që programet rishikohen çdo fillim semestri nga Titullari i Lëndës, përpara se të miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit⁵⁷. Literatura bazë dhe e rekomanduar në një pjesë të silabuseve është bashkëkohore, pasi mundësohet edhe nga përdorimi i bibliotekës elektronike EBSCO dhe Sage, në të cilën institucioni është i abonuar. Gjithashtu, rezulton se literatura e detyruar dhe ndihmëse është e përcaktuar qartë por, në disa silabuse duhet të ketë rifreskim të literaturës bazë.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave</p>	<p>Konstatohet që përmbajtja e programit të studimit kombinon teorinë me praktikën duke synuar që studentët të</p>

⁵⁴ Ibid

⁵⁵ UET. "Plani Strategjik UET 2015-2020. Prioritetet në Procesin Mësimor, pika 4", ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁵⁶ UET. "Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës, pika A.III.8", ASCAL. Dok. nr.100.39. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁵⁷ UET. "Dokumenti A.III, Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës, pika A.III.12.2", ASCAL. Dok. nr.100.39. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	zhvillojnë aftësi dhe shprehi praktike dhe krijuese përsa i përket formimit pedagogjik të studentëve. <i>Sugjerojmë që të ketë një hapësirë më të madhe në përmbajtjen e programit për përfitimin e dijeve, aftësive, si edhe kompetencave në specialitetet që studentët zgjedhin</i>								
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ndërtimi i programit u mundëson studentëve që me mbarimin e ciklit të studimit të vazhdojnë ushtrimin e profesionit të mësuesit, pas marrjes së licencës. Gjithashtu, studentët të cilët janë të interesuar për thellimin e njohurive kërkimore-shkencore, mund të realizojnë vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë.								
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Departamenti ka një praktikë aktive ⁵⁸ për përmirësimin e programeve të studimit duke marrë në konsideratë mendimet dhe propozimet e grupeve të interesit.								
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Programi i studimit ofron njohuri kërkimore duke u mundësuar studentëve vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i kontraktuar për zhvillimin e programit të studimit zotëron grada dhe tituj të ndryshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi duke patur ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve të caktuara. Nga të dhënat që morëm gjatë vizitës në institucion rezultoi se për vitin akademik, për semestrin e parë 2019-2020, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie

⁵⁸ UET. “Bordi i Tregut të Punës 2018-2019”, ASCAL. Dok. nr.21.12.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

	<p>gjithsej 13 personel akademik nga ku 7 personel akademik efektiv(PAE) dhe 6 personel akademik me kontratë(PAK), të gjithë me grada/tituj.</p> <p>Pra raporti PAE/PAK për këtë vit akademik është 7/6.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 54% nga PAE.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Përgjegjësi i programit ka përvojë të gjatë akademike dhe ka titullin “Profesor i asociuar” ndërsa personeli tjetër akademik, si ai me kohë të plotë ashtu edhe personeli me kohë të pjesshme kanë grada dhe tituj të tjerë. Në stafin mësimor të vitit 2018-2019 përfshihen edhe 3 personel Prof. Dr., 3 Prof. Asoc., 7 Dr., 1 MND, si edhe 2 pedagogë me Msc. në pozicionin e asistentit.⁵⁹</p> <p>Numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi, ndër vite është si më poshtë: <i>(sipas DVV)</i></p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 17 pedagogë gjithsej, nga të cilët 12 personel akademik efektiv (PAE), nga ku 10 me tituj/grada dhe 2 me Msc. Mbulimi i programit në përqindje është 71% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 13 pedagogë gjithsej, nga të cilët 11 personel akademik efektiv (PAE), nga ku 7 me tituj/grada dhe 4 me Msc. Mbulimi i programit në përqindje është 85% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 10 pedagogë gjithsej, nga të cilët 9 personel akademik efektiv (PAE), nga ku 8 me tituj/grada dhe 1 me Msc. Mbulimi i programit në përqindje është 90% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2015-2016 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 9 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 personel akademik efektiv (PAE), të gjithë me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është 77.7% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2014-2015 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 10 pedagogë gjithsej, nga të cilët 6 personel akademik efektiv (PAE), 5 me tituj/grada dhe 1 Msc. Mbulimi i programit në përqindje është 60% PAE.</p>

⁵⁹ UET. “Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ndër vite”, ASCAL. Dok. nr.84.24. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

	Për vitin akademik 2013-2014 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 8 pedagogë gjithsej, nga të cilët 5 personel akademik efektiv (PAE), nga ku të gjithë me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është 62.5% PAE .			
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Departamenti përkatës, i ndihmuar nga Zyra e Karrierës, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani të ndryshme private me qëllimin akomodimin e studentëve në përputhje me këto akomodime si edhe për të ftuar ekspertë të jashtëm në auditorët e UET. ⁶⁰ Nën mbikëqyrjen e një pedagogu të departamentit i cili shërben edhe si këshillues karriere, departamenti zgjedh ekspertët e fushës të cilët do të referojnë në seanca të caktuara të programit të studimit. ⁶¹ Gjatë kryerjes së punimeve të diplomës studentët kanë në dispozicion të tyre stafin akademik udhëheqës. ⁶²			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor/shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Nga shqyrtimi i silabuseve të programit të studimit, si edhe nga vizita në mjediset e institucionit për këtë program studimi nuk parashikohen orë laboratorike. <i>Sugjerojmë shtimin e praktikave laboratorike për profilet Shkencat e Natyrës, Gjuhët dhe Komunikimi, si edhe shtimin e mjediseve ateljere për profilin Artet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në

⁶⁰ UET. "Marrëveshjet e bashkëpunimit", ASCAL. Dok. nr.98.34. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁶¹ UET. "Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale, pika B.I.3.1", ASCAL. Dok. nr.93.32.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. "Rregullore e zyrës së këshillimit dhe karrierës", ASCAL. Dok. nr.20.12. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁶² UET. "Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit", ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbytjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Sipas statutit të UET (neni 30, pika 30.4) parashikohet se çdo program studimi konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me Bordet e Tregut të Punës të ngritur në nivel departamenti. Gjithashtu, në përputhje me statutin e UET, programohen politika dhe merren masa të ndryshme për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, në përputhje si me zhvillimet teorike bashkëkohore ashtu edhe me ato praktike që lidhen me tregun e punës. ⁶³		
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Me qëllim përfshirjen e studentëve në marrjen e vendimeve të ndryshme, Statuti i UET parashikon përfaqësimin e studentëve me anëtarë në Senatën Akademik, në Këshillin e Etikës, si edhe në KSBC. Kjo politikë ndiqet edhe në Planin Strategjik 2015-2020. Pranë departamentit është krijuar Bordi i Tregut të Punës me anëtarë nga rradhët e UET Alumni, të shquar në karrierën e tyre pranë institucioneve ku janë punësuar. Departamenti zhvillon çdo muaj mbledhje të hapur me qëllim marrjen e mendimeve të studentëve për përmirësimin e programit. ⁶⁴		
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Marrja e propozimeve të natyrave të ndryshme prej studentëve të diplomuar realizohet përmes rrjeteve ALUMNI të ngritura mbi bazë universiteti. Gjithashtu, përmes këtyre rrjeteve studentët e diplomuar përfshihen në strukturat drejtuese/konsultuese si edhe marrin pjesë në aktivitete apo projekte të ndryshme. Kjo politikë është konstante dhe është në qendër të Planit Strategjik të UET për vitet 2015-2020. ⁶⁵		
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	UET bashkëpunon në nivel universiteti apo departamenti me institucione të ndryshme publike dhe private, me struktura të pushtetit vendor dhe përshtat programe të posaçme në përputhje me nevojat specifike që kanë këto njësi. Shprehimisht, ka patur bashkëpunim me Zyrën Rajonale Arsimore Tiranë dhe me ASCAP-in (IZHA-n).		
Shkalla e përmbushjes së	Not	Përmbushet	Përmbushet

⁶³ UET. "Statuti UET, neni 30, pika 30.4", ASCAL. Dok. nr.4.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁶⁴ UET. "Statuti i UET Neni 16, 18.4, 19.2.4, 19.6.2", ASCAL. Dok. nr.4.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. "Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Departamentit. F.V.2.3", ASCAL. Dok. nr.9.6. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. "Plani Strategjik, f. 5", ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁶⁵ UET. "Plani Strategjik, 2015-2020, pika 3", ASCAL. Dok. nr.5.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.7				
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në bazë të rregullores së programit të studimit, janë përcaktuar qartë prioritetet si edhe objektivat kryesorë të studimit dhe të kërkimit shkencor ku pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është edhe puna kërkimore, e cila konceptohet në mbështetje të programit të studimit. ⁶⁶			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike. Një nga këto forma organizimi janë edhe forumet UET. ⁶⁷			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga bisedat me studentët gjatë vizitës në institucion u konstatua se programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Institucioni organizon aktivitete të vazhduara ku pedagogët kanë mundësi të paraqesin punët kërkimore dhe shkencore të tyre. ⁶⁸			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Referuar RVB, njësia bazë ka një mbështetje të konsiderueshme nga institucioni. Akademikët në UET janë të inkurajuar që të hulumtojnë dhe të publikojnë arritjet e tyre kërkimore dhe shkencore, dhe në bazë të performancës së tyre marrin edhe grantet e tyre kërkimore ⁶⁹ .			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

⁶⁶ UET. "Rregullorja e programit të studimit, pika 3.3", ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁶⁷ UET. "Kalendari i Aktiviteteve Shtator 2016 – Shtator 2019", ASCAL. Dok. nr.173.56 . Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁶⁸ UET. "DSSH", ASCAL. Dok. nr.161-171. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁶⁹ UET. "RVB, Master i Shkencave, Mësuesi për Arsimin e Mesëm", ASCAL. Dok. nr.2. Fq.22.. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

Standardi II.8				
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore brenda institucionit. Këto projekte kërkimore inkurajojnë bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe mundësojnë koordinimin shkencor.			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia përgjegjëse ka ngritur grupet kërkimore që janë një mekanizëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë të produktit shkencor. Grupet kërkimore shërbejnë gjithashtu edhe si “strehë” për doktorantët të cilët atashohen pranë një grupi kërkimor dhe zhvillojnë pranë tyre punimin doktoral.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Një nga aktivitetet që organizon Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve është edhe Konferenca “Ditët e studimeve shqiptare”. Kjo konferencë ndihmon stafin akademik si edhe studentët për arritjen e objektivave kërkimore-shkencore. ⁷⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

⁷⁰ UET. “DSSH”, ASCAL. Dok. nr.161-171. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ ka konstatuar se parimet e hartimit të silabuseve, metodave të mësimdhënies, përzgjedhjes së literaturës, sistemeve të kontrollit dhe të cilësisë dhe të vlerësimit, etj., ndërtohen në bazë të udhëzimeve specifike.⁷¹ UET dhe departamentit përkatës mbështet stafin akademik për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme zhvilluese brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>UET zhvillon trajnime të ndryshme të vazhdueshme lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies duke nxitur përdorimin e metodave të reja sipas specifikave të fushës përkatëse.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar u konstatua që institucioni zbaton formate të ndryshme të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies. Për anëtarët e personelit akademik, kryesisht të kategorisë lektorë dhe asistent/lektorë, si PAE ashtu edhe PAK, janë këto formate vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i mësimdhënies në auditor. Ky proces realizohet nga përgjegjësi i gruplëndës, përgjegjësi i departamentit apo dekani; ▪ Vlerësimi nga studentët.⁷² Ky proces realizohet nga studentët të cilët përdorin një format të vlerësimit duke ruajtur anonimatën e tyre. Për këtë qëllim janë realizuar edhe fokus grupe me studentët; ▪ Procesi i vetëvlerësimit;

⁷¹ UET. "Dokumenti A.III, Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literatures, pika A.III.12.2", ASCAL. Dok. nr.100.39. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. UET. "Rregullorja e Programit të Studimit, pika 3.3", ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁷² UET. "G III-4-2.Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët". ASCAL. Dok. nr.125.40. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rezultatet e raporteve të KSBC-së; ▪ Vlerësimi nga Komisionet e Vlerësimit të Performancës të cilat ngrihen nga Rektori.⁷³ 								
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Programi ofron forma për vlerësimin e performancës së personelit akademik, lidhur me mësimdhënien por edhe me aspekte të sjelljes, të komunikimit, etj.</p> <p>Për këtë organizohen takime periodike me “fokus grupe” të caktuara si edhe plotësohen pyetësorë me bazë semestrale ku tërhiqet mendimi i studentëve për programin në tërësi apo për çdo pedagog të veçantë lidhur me metodat e mësimdhënies. Gjithashtu, ankesat dhe sugjerimet e çdo lloji mund të drejtohen pranë Zyrës së Kujdesit të Studentit apo pranë Përgjegjësit të Departamentit apo Sekretarit të Përgjithshëm. Ankesat individuale lidhur me vlerësimin e studentëve rregullohen sipas nenit 32 të Rregullores së UET dhe trajtohen nga Përgjegjësi i Departamentit⁷⁴.</p>								
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Komisioni i Sigurisë së Brendshme të Cilësisë është një strukturë permanente që funksionon pranë UET. KSBC përpunon të dhënat e marra nga rezultatet e vlerësimit dhe më pas këto të dhëna i komunikohen organeve drejtuese të UET nëpërmjet komunikimeve periodike⁷⁵. Përgjegjësi i Departamentit i komunikon të dhënat tek anëtarët e personelit akademik. Rezultatet vlerësohen në rang departamenti dhe më pas merren masa për përmirësime të mëtejshme.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Institucioni ka disa mekanizma aktivë, ku përfshihet edhe KSBC që realizon procesin e vlerësimit. Referuar RVB, të dhënat e marra nga këto mekanizma shërbejnë për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brëndshme⁷⁶.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

⁷³ UET. “Rregullore e UET, Neni 22”, ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁷⁴ UET. “Rregullore e UET, Neni 22, pika 22.2.b”, ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁷⁵ UET. “Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset”, ASCAL. Dok. nr.108.30.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁷⁶ UET. “RVB, Master i Shencave, Mësuesi për Arsimin e Mesëm” fq. 25, ASCAL. Dok. nr.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: http: Sistemin AMS te ASCAL.

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstatoi se si rregull i përgjithshëm, UET aplikon si forma mësimdhënieje leksionet, seminarët, detyrat e kursit, esetë, projektet, praktikat profesionale dhe orët e hapura me lektorë të ftuar; si edhe punim diplome.⁷⁷</p> <p>Në planin mësimor, orët në auditor rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 420 orë; - Seminare 210 orë; - Ushtrime/projekte/detyra 255 orë; - Praktikë profesionale 255 orë; - Punim diplome 36 orë⁷⁸; <p>Kontrolli i dijeve është mbi baza të vazhdueshme në mënyrë që identifikimi i mangësive apo përmirësimet e mundshme të realizohen përpara mbarimit të semestrit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Nga biseda me studentët gjatë vizitës në institucion u konstatua se personeli akademik synon krijimin e mundësive të barabarta për çdo student, duke shmangur çdo formë diskriminimi të çfarëdolloj natyre. Nisur nga natyra e programit të studimit si edhe nga reagimet e marra nga studentët, përdoren forma të ndryshme të mësimdhënies, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, të tilla si detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studimi mbi bazë grupi, mjete audio-vizive, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në mënyrë specifike, UET organizon <i>Ditën e Zhvillimit të Stafit</i> me qëllim trajnimin lidhur me mësimdhënien apo kërkimin shkencor si edhe në fillim të çdo viti akademik organizohet trajnimi dy ditor <i>Back to Ëork</i>. Gjithashtu, UET ndjek politikën e shkëmbimit të stafit me universitete të ndryshme perëndimore, për të shkëmbyer dhe njohur praktikat më të mira të mësimdhënies dhe të të nxënit.⁷⁹</p>

⁷⁷ UET. "Dok. A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës" pika A.III.3, ASCAL. Dok. nr.100.39. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁷⁸ UET. "Plani mësimor i programit", ASCAL. Dok. nr.178.14.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁷⁹ UET. "Të dhëna për shkëmbimin e stafit", ASCAL. Dok. nr.131.43.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Referuar edhe CV-ve të stafit akademik⁸⁰ të administruara në paketën e dokumentacionit dorëzuar nga institucioni UET, konstatohet se i gjithë stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie në MSH “Mësuesi për Arsimin e Mesëm” ka formimin e duhur bazë dhe të avancuar për të qënë pjesë akademike e programit.</p> <p>Stafi është me tituj dhe grada shkencore. Nga bisedat me studentët rezultoi se pedagogët zbatonin në klasë metoda interaktive të mësimdhënies ku njohuritë jepeshin duke u mbështetur në situata praktike të të nxënit.⁸¹</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni ka në qëndër të vëmendjes përfshirjen e studentëve në përmirësimin e cilësisë së personelit akademik dhe të metodave të mësimdhënies. Pas marrjes së mendimeve, sugjerimeve, apo edhe vërejtjeve të ngritura nga studentët, përgjegjësit e departamenteve apo organet më të larta drejtuese bëjnë verifikimet e duhura dhe marrin masat e ndryshme përmirësuese, që mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndryshime në programin e një lënde të caktuar; ▪ Ndryshime të kurrikulës së programit; ▪ Ndryshim të personelit akademik në rast të konstatimit të moskompetencës apo të mungesës së angazhimit.
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Nga vizitat në institucion dhe nga bisedat me studentët, rezultoi se pedagogët, gjatë zhvillimit të procesit mësimor, përdorin metoda interaktive për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë, kritik dhe krijues. Gjithashtu, nga analizimi i silabuseve të programit, u konstatua që metoda të tilla si prezantime, diskutime mbi konceptet kryesore, punë me grupe për zbatimin e koncepteve të mësuara zënë një vend të konsiderueshëm në metodologjinë e zhvillimit të lëndës.⁸²</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Nga analiza e silabuseve të programit, u konstatua që i është lënë hapësirë punës së pavarur dhe prezantimeve të studentëve. Kjo është arritur përmes rekomandimit për të studjuar jashtë auditorit në mënyrë të pavarur literaturë apo artikuj të ndryshëm shkencorë. Gjithashtu, nga bisedat me studentët, rezultoi se një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve, duke</p>

⁸⁰ UET. “Paketa e CV-ve të Stafit Akademik”, ASCAL. Dok. nr.65-80.

⁸¹ UET. “Formati i silabusit”, ASCAL. Dok. nr.31.19.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS të ASCAL.

⁸² UET. “Paketa e silabuseve lëndore”, ASCAL. Dok. nr.32-64. Parë në Nëntor 2019

	vlerësuar në këtë mënyrë jo vetëm dijet por edhe aftësitë e punës në grup. ⁸³		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita në institucion u konstatua që e gjithë infrastruktura e cila ishte në funksion jo vetëm të procesit mësimor, plotëson të gjitha standardet. Kështu, çdo sallë leksioni dhe seminari ishte e pajisur me PC dhe me projektor. Në funksion të këtij programi ishte një laborator informatike që ishte në funksion të procesit mësimor të këtij program studimi. Në ambjentet e institucionit funksiononte normalisht sistemi i kondicionimit dhe ambjentet ishin të mirëmbajtura duke bërë të mundur krijimin e një mjedisi fizik të përshtatshëm dhe komod për punë ⁸⁴ .
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Institucioni kishte funksionale 33 salla mësimore në funksion të programit mësimor të pajisura me mjetet e duhura për zhvillimin normal të procesit mësimor, duke përfshirë PC dhe deri te fonia në rastin e sallave të leksioneve. Laboratorët e informatikës ishin të pajisur me software-t përkatës, ku sistemet e operimit ishin Windows 7, me paketën e plotë Microsoft Office ⁸⁵ .
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Nga vizita në Institucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, u konstatua që UET kishte funksional një sistem operimi Moodle (UET LMS), që bën të mundur aksesimin në kohë reale të studentëve, me gjithë informacionet e duhura për lëndën dhe gjithë detyrimet e akademike të lidhura me të ⁸⁶ .
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të	Nga analiza e silabuseve të lëndës, u konstatua që për çdo

⁸³ Ibid

⁸⁴ UET. "Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit", ASCAL. Dok. nr.128.42. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁸⁵ ASCAL. "Dokumenti i vizitës në Institucion data 4,5 dhe 6 Nëntor".

⁸⁶ UET. "Të dhëna mbi platformën Learning Management System", ASCAL. Dok. nr.146.46.1, 147.46.2, 148.46.3. Parë në Nëntor 2019, gjenden në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>silabus kishte literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse. Kjo literaturë ishte në dispozicion të studentëve si në formatin fizik në bibliotekë, ashtu dhe në formatin elektronik në sistemin LMS nga pedagogu i lëndës. Institucioni kishte procedura të përcaktuara për sa i përket rifreskimit të bibliotekës me tituj të rinj të cilat ishin në funksion të të gjithë procesit mësimor⁸⁷.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor Institucioni kishte një bibliotekë të vendosur në një hapësirë me dritë natyrale. Biblioteka kishte rreth 150 vende ulëse leximi dhe funksionale me rreth 12 PC të vëna në dispozicion të studentëve. Biblioteka kishte rreth 180 tituj të cilët ishin në fushën e edukimit, nga të cilët 120 janë në gjuhën shqipe dhe 60 janë në gjuhë të huaj dhe që i shërbenin procesit mësimor⁸⁸. Biblioteka ishte e abonuar edhe në librarinë elektronike Sage & Ebsco dhe Questia. Biblioteka kishte të afishuar në një vënd të dukshëm orarin të përshtatur dhe sipas nevojave të studentëve si gjatë zhvillimit të procesit mësimor, ashtu edhe gjatë sesioneve të provimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua që biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBBIS.net, një rrjet ku përfshihen të gjitha vendet e Rajonit të Europës Juglindore dhe ku mundësohet lidhja e bibliotekave në sistemin e informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse. Biblioteka kishte të siguruar akses në disa burime ndërkombëtare elektronike si Questia apo Social Science Library dhe disa revista shkencore të huaja si Educational Leadership, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizitat në institucion u konstatua që UET kishte infrastrukturën e nevojshme për të realizuar objektivat mësimorë të programit Master Shkencor “<i>Mësuesi për Arsimin e Mesëm</i>”. Studenti mund të punonte për realizimin e detyrimeve lëndore apo të programit, ose në biblioteke ose në sallat e informatikës të cilat ishin të pajisura me softëare-t e duhur për këtë gjë. Gjithashtu, mund të përmendim që në të gjitha PC ishte instaluar programi SPSS, Versioni 21, një program ky i domosdoshëm për zhvillimin e lëndës “Metodat Kërkimi</p>

⁸⁷ UET. “*Inventari i teksteve Edukim; Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës*”, ASCAL. Dok. nr.135.45. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁸⁸ Ibid

	Sasiore”.								
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni kishte funksional sistemin MOODLE, UET LMS, ku studenti mund të aksesonte në kohë reale të gjithë informacionin e duhur për realizimin e objektivave dhe rezultateve të të nxënit të programit. Gjithashtu, me anë të këtij sistemi studenti mund të informohej në çdo kohë me të gjithë informacionin personal si notat, frekuentimin, pikët, etj. ⁸⁹								
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Institucioni ka një sistem funksional të brendshëm Intranet të të gjithë dokumentacionit UET, ku paraqiten programet lëndore, legjislacioni specifik përkatës, urdhrat e brendshëm institucionalë, etj. Gjithashtu, përmes platformës UET MLS ⁹⁰ , që është në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve, mundësohet shkëmbimi në kohë reale i të gjithë informacionit të duhur në funksion të procesit mësimor.								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Programi Master i Shkencave “Mësuesi për Arsimin e Mesëm” me profile, ka si provë finale për procesin e diplomimit Punimin e Diplomës ⁹¹ me 12 ECTS. Për këtë rast, institucioni përcakton personelin e duhur që udhëheq dhe monitoron këtë proces duke zhvilluar me studentët seanca metodologjike, që kanë për qëllim të ndihmojnë studentët për aspektin kërkimor-shkencor të projektit dhe deri në paraqitjen e tij. ⁹²								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që	Institucioni ka efektiv në nivelin e funksionimit Komisionin e Përhershëm dhe Autonom (Komisionin e Sigurimit të

⁸⁹ UET. “Të dhëna për platformën LMS”, ASCAL. Dok. nr. 146.46.1, 147.46.2, 148.46.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁹⁰ Ibid

⁹¹ UET. “Plani mësimor i programit”, ASCAL. Dok. nr.178.14.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁹² UET. “Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”, ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Brëndshëm të Cilësisë). Gjatë bisedës me stafin e këtij komisioni, si edhe nga dokumentacioni i paraqitur nga UET⁹³, u konstatua që ky komision vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe propozon ndryshime në funksion të rritjes së cilësisë së gjithë procesit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Përcaktuar edhe nga Ligji i Arsimit të Lartë, departamenti që ofronte dhe programin e studimit ishte përgjegjës për gjithë cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet që ai ofronte. Njësia bazë merrej si me formën ashtu dhe me përmbajtjen e të gjithë procesit, duke garantuar që mësimi të zhvillohet nga personel akademik me ekspertizën dhe kualifikimin e duhur. Procedurat e monitorimit dhe vlerësimit që ndërmerren nga njësia bazë janë transparente dhe të njohura paraprakisht nga të gjithë që në fillim të të gjithë procesit⁹⁴.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i silabuseve konstatohet që personeli akademik ka të evdidentuar në një seksion të veçantë të gjithë metodologjinë që duhet të përdorë për të aplikuar metodat innovative në procesin mësimor. Kjo zakonisht është e pasqyruar me tipet e materialeve audio-vizive të cilat janë në funksion të procesit të mësimdhënies⁹⁵.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua që personeli akademik duhet të përfshijë në programet e lëndës edhe rezultatet e veta të kërkimeve shkencore.⁹⁶ Janë organizuar trajnime një ose më shumë ditore për të rritur aftësitë akademike dhe për të mundësuar që puna kërkimore-shkencore të botohet në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet e mësipërme janë ndarë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnime për doktorantë; - Trajnime për Junior Researchers; - Trajnime për Senior Researchers; - Trajnime metodologjike;⁹⁷

⁹³ UET. "Dokumentimi F.VII. Mbi sigurimin e Brëndshëm të Cilësisë", ASCAL. Dok. nr.14.8. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁹⁴ UET. "G-III-4-1. Formular i vlerësimit të pedagogut nga eprori/kolegu", ASCAL. Dok. nr.109.30.8. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁹⁵ UET. "Formati për hartimin e silabusit", ASCAL. Dok. nr.31.19.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁹⁶ UET. "Formati për hartimin e syllabusit, Seksioni për literaturën e rekomanduar", ASCAL. Dok. nr.31.19.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁹⁷ UET. "Strategjia e kërkimit Shkencor 2017-2020, pika 1.2, 3.4, 6, dhe 12", ASCAL. Dok. nr.6.3.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Politikat e UET mundësojnë trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e aftësisë mësimdhënëse përmes shkëmbimit të përvojës në kuadër të programeve Erasmus +KAl me universitete partnere⁹⁸ si edhe përmes trajnimeve të vazhdueshme të zhvilluara me ndihmën e lektorëve të ftuar apo me ndihmën e personelit të UET.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Metodat e mësimdhënies janë nën lirinë akademike individuale të personelit akademik. Institucioni vetë ka konstatuar faktin se pavarësisht përpjekjeve të institucionit për të promovuar përdorimin e metodave të reja, ka ende rezistencë të fshehur nga brezi më i moshuar i personelit mësimdhënës. E kundërta vihet re tek brezi më i ri i personelit akademik që i përfaqon më shpejt metodat e reja të mësimdhënies.⁹⁹</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Siç u theksua edhe më sipër, personeli akademik në UET ka autonominë e zgjedhjes dhe të përdorimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe mund të ndikojë që ndryshimet e duhura pozitive të pasqyrohen në periudhën e rishikimit vjetor të silabuseve. Në mbledhjet e departamentit inkurajohet ndarja e përvojës vetjake ndërmjet kolegëve, ku synohet që metodat e përparuara dhe me ndikim pozitiv të ndiqen dhe të shfrytëzohen edhe nga kolegët e tjerë.¹⁰⁰</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Nga dokumenatacioni i dorëzuar, rezulton që është në praktikën e mësimdhënies së institucionit që të ftohen lektorë të jashtëm/të huaj¹⁰¹ dhe profesionistë të fushës me qëllim pasurimin e procesit të mësimdhënies. Edhe në rastin e programeve Master i Shkencave në Mësuesi me profile, është synuar që temat mësimore të jenë me natyrë praktike dhe të pranueshme për studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5

⁹⁸ UET. "Të dhëna për shkëmbimin e stafit", ASCAL. Dok. nr.131.43.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

⁹⁹ UET. "RVB, Master i Shkencave, Mësuesi për Arsimin e Mesëm, faqe 31", ASCAL. Dok. nr.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁰⁰ Ibid

¹⁰¹ UET. "Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore, pika G.1.4 Lektorët e huaj." ASCAL. Dok. nr.18.11. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni ka hartuar dokumente rregullatore transparente që normojnë kriteret, mënyrën e vlerësimit, si edhe njohjen e tyre prej studentëve. ¹⁰² Studentët e rinj njihen me procedurat e mësipërme gjatë javës së orientimit dhe më hollësisht, procedurat prezantohen nga titullari i lëndës gjatë momentit të prezantimit të silabusit. Gjithashtu, studentëve u mundësohet në mënyrë të vazhdueshme edhe ndihma që jepet nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm e ofruar nga Koordinatorja e Departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit.								
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar paketës së silabuseve që institucioni ka dorëzuar, si edhe nga bisedat e zhvilluara me studentët e Master Shkencor “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, konstatohet se pedagogët që mbulojnë disiplinat e këtij programi kanë të pasqyruara qartë në silabuse dhe zbatojnë formate të qarta të procesit të vlerësimit të vazhduar dhe të vlerësimit përmblëdhës. ¹⁰³ Këto metoda janë të pasqyruara edhe në platformën LMS, si edhe mund të dërgohen përmes postës elektronike nga koordinatoresha e departamentit.								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Në rregulloren e institucionit parashikohen forma të ndryshme të vlerësimit të dijeve, duke i dhënë mundësi pedagogut të lëndës që të zgjedhë ato metoda që i përshtaten një lënde të caktuar që janë më të përshtatshme për të evidentuar rezultatet e të nxënësit. ¹⁰⁴								
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Asnjë përmbushje</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

¹⁰² UET. “Rregullorja e programit të studimit”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve”, ASCAL. Dok. nr.11.7.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. Rregullorja e UET, Neni 24. Gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁰³ UET. “Paketa e silabuseve lëndore”, ASCAL. Dok. nr. 32-64. Parë në Nëntor 2019

¹⁰⁴ UET. “Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve”, ASCAL. Dok. nr.11.7.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Është në politikën e institucionit vlerësimi i përgatitjes akademike në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit shkollor përmes provimeve të ndërmjetme, nivelit të diskutimeve në seminare, detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike. Nëse studenti e kalon pragun e prezencës prej 80% në një lëndë të caktuar ai i nënshtrohet provimit përfundimtar të lëndës dhe nota përfundimtare është një kombinatore e katër elementëve të mësipërm. Raporti i këtyre katër elementëve në notën përfundimtare është:</p> <p>10% niveli i diskutimeve në seminare; 30% provimi i ndërmjetëm; 20% detyra e kursit; 40% provimi përfundimtar.¹⁰⁵</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB-së, institucioni në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) priret që të promovojë një sistem të ri vlerësimi elektronik: “Clean scoring”.¹⁰⁶</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>UET praktikon vlerësimin me komision në rastet e detyrimeve të praktikës profesionale dhe punimit të diplomës¹⁰⁷. Institucioni ndjek një procedurë të përcaktuar në rastin e vlerësimit të studentëve me aftësi shikimi të kufizuar, ku komisioni duhet të përbëhet nga dy anëtarë ku njëri prej tyre duhet të jetë titullari i lëndës/modulit¹⁰⁸.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të</p>	<p>Konfirmuar edhe nga Rregullorja e Programit të Studimit¹⁰⁹, të gjitha format e testimit me shkrim si të vazhduar ashtu dhe përfundimtare zhvillohen duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit. Ky proces kryhet nga Koordinator i Departmentit dhe Sekretaria Mësimore¹¹⁰.</p>

¹⁰⁵ UET. “Rregullorja e programit të studimit, pika 5.2”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. *Paketa e silabuseve lëndore*, ASCAL. Dok. nr.32-64. Parë në Nëntor 2019

¹⁰⁶ UET. “RVB, Master i Shencave, Mësuesi për Arsimin e Mesëm, faqe 33”, ASCAL. Dok. nr.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁰⁷ UET. “Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 5.3.3”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “Rregullore UET, neni 27, pika 4”, ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁰⁸ UET. “Urdhër për vlerësimin e studentëve me aftësi shikimi të kufizuar”, ASCAL. Dok. nr.13.7.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁰⁹ UET. “Rregullorja e programit të studimit, pika 5.3”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹⁰ UET. “Dokument i E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore”, ASCAL. Dok. nr.15.9. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Proceset e kontrollit të dijes zhvillohen konform të gjitha rregullave institucionale. ¹¹¹
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Procedurat e vlerësimit rezultojnë të jenë transparente, ku stafi akademik realizon vlerësim të arsyetuar të të gjithë komponentëve të parashikuar në detyrimet akademike. Në kuadër të këtij procesi, pedagogët realizojnë edhe seancat sqaruese me studentët, ku këta të fundit marrin dhe komentet për vlerësimin e tyre. ¹¹²
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregullat e zhvillimit të kontrolleve të dijes përcaktohen në dokumentat përkatëse të institucionit ¹¹³ . Gjithashtu, në Rregulloren e UET, janë të specifikuar mjaft qartë dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës. ¹¹⁴ Që prej viti 2015, Institucioni disponon të implementuar sistemin antiplagjiaturë, <i>Turnitin Ephorus</i> , ku realizohet kontrolli elektronik i punimeve të studentëve të të gjitha cikleve, përpara se të marrin vlerësimin nga pedagogu.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Përmes sistemit online MOODLE UET LMS, studenti informohet brënda afateve të përcaktuara nga institucioni për rezultatet e provimit. Gjithashtu, pedagogët përcaktojnë orare për seancat sqaruese me studentët.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni ka dokumentacion të plotë ¹¹⁵ që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloren dhe procedurat e vlerësimit. Garantimi i të drejtave të studentëve për këtë pikë u konfirmua dhe nga bisedat me ta nga vizitat në institucion.

¹¹¹ UET. "Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve", ASCAL. Dok. nr.11.7.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹² UET. "Formati i tezës së provimit përfundimtar", ASCAL. Dok. nr.12.7.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹³ UET. "Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6.b", ASCAL. Dok. nr.11.7.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹⁴ UET. "Rregullore UET, Neni 33", ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹⁵ UET. "Rregullorja mësimore e Programit të Studimit", ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Në rastet e ankimimeve apo kontestimeve në lidhje me procedurat e vlerësimit, institucioni garantonte shqyrtimin e çështjes duke ngritur një komison ad-hoc për këtë qëllim¹¹⁶. Dokumentacioni i mbajtur për këtë qëllim arkivohej.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Referuar takimeve me stafin akademik dhe studentët e programit rezultoi se programi i studimit Master i Shkencave në “<i>Mësuesi për Arsimin e Mesëm me 7 profile</i>”, zhvillohet që të garantojë thellimin e njohurive, sidomos në aspektin pedagogjik, dhe t’i japë studentit, i cili më pas do të jetë mësues për arsimin e mesëm, shprehi praktike për ushtrimin e profesionit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit synon të formojë mësues të ciklit të mesëm të ulët dhe të ciklit të mesëm të lartë efektivë dhe kompetentë për mësimdhënien. Duke qënë se vetë programi i studimit është një program i fushës sociale dhe që prek komunikimin dhe ndërveprimin, programi ka të ndërthurur në kurrikulën e tij të gjithë këta elementë¹¹⁷. <i>Sugjerohet që në kurrikulën e programit, në lëndët e kategorisë “C” ku studentët profilizohen në profile specifike t’i jepet më shumë peshë komponentit të përgatitjes shkencore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në</p>	<p>Për këtë program studimi, organizimi i disiplinave është i tillë që lejon si pedagogët ashtu dhe studentët që të bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara duke mundësuar marrjen e mendimit të</p>

¹¹⁶ UET. “Rregullorja mësimore e Programit të Studimit, pika 5.8”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹⁷ UET. “Kurrikula e programit të studimit”, ASCAL. Dok. nr.24.14. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

përfundim të lëndës.	studentëve për formatin e eseve, ose për çfarë mund të përmirësohet në vazhdim ¹¹⁸ .
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Stafi akademik ishte në dispozicion të studentëve për të ripërforcuar procesin njohës, analizues, krijues dhe gjykues gjatë të nxëniet për konceptet e ofruara nga disiplina ¹¹⁹ . Gjithashtu, pedagogët ishin në dispozicion të studentëve sipas një kalendari paraprak për konsultat përpara provimit.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Si nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni, ashtu dhe nga vizita e realizuar, u kontaktua që kishte një aktivitet të pasur në kuadrin e zhvillimit të orëve të hapura si nga stafi i brëndshëm ashtu dhe nga stafi i jashtëm akademik ¹²⁰ .
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia e realizuar në cilësinë e saj ka të përcaktuara objektivat dhe rezultatet e të nxëniet të cilat synojnë ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike. Kështu, në çdo lëndë të programit është parashikuar të zhvillohet një detyrë kursi, e cila mbart dhe 20% të vlerësimit përfundimtar. Praktika profesionale gjithashtu është lëndë e detyrueshme për këtë program studimi ¹²¹ .
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Nga vizitat në institucion u konstatua që UET, e konsideron mjaft të rëndësishme punën në grup në të gjitha qelizat institucionale të tij. Kjo mundëson edhe zgjidhjen më të mirë të problemeve/çështjeve apo situatave të krijuara.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Institucioni ka një strategji të kërkimit shkencor, e arritshme nga gjithë të interesuarit në intranet, që stimulon dhe përforcon arritjen akademike të stafit dhe bashkëpunimin me kolegët në kuadër të grupeve kërkimore dhe shkencore të organizuara në nivel njësie bazë/kryesore të institucionit ¹²² .
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e	Institucioni ka një politikë të qartë për mbështetjen e ideve inovative për studime të avancuara si për studentët ashtu

¹¹⁸ UET. "Formati për hartimin e silabusit", ASCAL. Dok. nr.31.19.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹¹⁹ Ibid

¹²⁰ UET. "Kalendari i aktiviteteve 2016-2019", ASCAL. Dok. nr.173.56. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹²¹ UET. "Kurrikula e programit të studimit", ASCAL. Dok. nr.24.14. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹²² UET. "Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020", ASCAL. Dok. nr.6.3.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	dhe për stafin akademik. Kjo gjë është e përcaktuar si në dokumentacionin e UET ¹²³ , ashtu dhe në praktikat që institucioni ndjek.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve	Institucioni ka një zyrë të projekteve dhe partneriteteve e cila është aktive për realizimin e këtij qëllimi. Shkëmbimet e personelit akademik dhe të studentëve, në kuadër të projekteve të ndryshme kanë mundur shkëmbimin e përvojës dhe përfitimin e praktikave, të cilat përgjithësisht adaptohen nga personelin akademik pas rikthimit në institucion ¹²⁴ . Në programin Master i Shkencave “Mësues për Arsimin e Mesëm” nuk kemi konstatuar shkëmbime akademike të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Së përbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Prova finale kryhet me anë të mbrojtjes së diplomës. ¹²⁵ Institucioni ka një praktikë të përcaktuar për punimin e diplomës ku jepet në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i punimit të diplomës deri tek procesi i mbrojtjes përpara komisionit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Institucioni disponon praktika transparente dhe dokument të qartë për punimin e diplomës, ku jepet në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet që nga faza e parë deri në fazën finale të mbrojtjes së diplomës ¹²⁶ .
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna	Duke qënë se detyrimi përmbyllës bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi realizohet vetëm përmes mbrojtjes së punimit të diplomës, të gjithë studentët e programit Master i

¹²³ Ibid

¹²⁴ UET. “Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UET”, ASCAL. Dok. nr.98.34. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹²⁵ UET. “Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës”, ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹²⁶ Ibid

gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Shkencave në Mësuesi për Arsimin e Mesëm, kanë detyrim ligjor ¹²⁷ të kryejnë një punim shkencor.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Pedagogu udhëheqës mentoron, monitoron, si edhe këshillon në të gjitha stadet e zhvillimit të punimit të diplomës, që nga stadi i zgjedhjes së temës së diplomës deri në stadin e paraqitjes së punimit të diplomës ¹²⁸ .
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni ka dokumenta në të cilat përcaktohen qartë të gjitha fazat nëpër të cilat pedagogu udhëheqës duhet të asistojë studentin përgjatë zhvillimit të punimit të diplomës, si në rastet e zgjedhjes së temave të cilat kërkojnë metodologji sasiore, ashtu edhe në rastet e zgjedhje së temave që kërkojnë metodologji cilësore ¹²⁹ .
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga bisedat me studentët gjatë vizitës në institucion, si edhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga UET, u konstatua që pedagogët udhëheqës të temave të diplomave, asistoni studentët si për përpunimin e të dhënave sasiore ashtu dhe për përpunimin e të dhënave cilësore ¹³⁰ . Gjithashtu, pedagogu udhëheqës miratonte nëse punimi ishte i plotë dhe i përshtatshëm për t'u paraqitur para komisionit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Prova finale në rastin e një punimi diplome, merrte një vlerësim me notë që ishte një mesatare aritmetike e të gjitha vlerësimeve të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Mbrojtjes së Diplomës. ¹³¹
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për	Nëse studenti përmbushte të gjitha detyrimet akademike të kërkesave të planit mësimor, si edhe nëse kishte shlyer të gjitha detyrimet ndaj Institucionit, bazuar në Rregulloren e Institucionit ¹³² , pajisej brënda një afati prej gjashtë muajsh me diplomën përkatëse ¹³³ të shoqëruar me çertifikatën e notave

¹²⁷ Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Parë në Nëntor 2019

¹²⁸ UET. "Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit, pika B.II.5", ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹²⁹ UET. "Dokumenti për punimin e diplomës, pika B.II.5.2", ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹³⁰ Ibid

¹³¹ UET. "Dokumenti B.II. për punimin e diplomës, pika B.II.13.4", ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹³² UET. "Rregullore e UET, Neni 40", ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹³³ UET. "Forma e Diplomës", ASCAL. Dok. nr.26.15. Parë në Nëntor 2019, gjendet në : Sistemin AMS te ASCAL.

arsimin.	dhe me suplementin e diplomës ¹³⁴ . Në periudhën e ndërmjetme të kësaj faze me kërkesë të studentit, UET pajiste studentin me një vërtetim për diplomën e fituar të shoqëruar me çertifikatën e notave.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti ka të drejtë të marrë një kopje të zyrtarizuar të silabuseve të programit të studimit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Nga vizita në Institucion u konstatua që Institucioni ka rekorde të plota të dokumentacionit të studentëve dhe e vendos këtë dokumentacion në dispozicion të strukturave të autorizuara konform ligjit të ruajtjes së të dhënave personale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo	Nga vizita në institucion u konstatua se UET ka funksionale Zyrën e Burimeve Njerëzore ¹³⁵ e cila kishte krijuar arkivën e Dosjeve Individuale ¹³⁶ si për PAE ashtu dhe për PAK, deri për vitin akademik 2018-2019. Të dhënat për vitin akademik 2019-2020 ishin akoma në proces përpunimi. Angazhimi i çdo anëtarit të personelit akademik për çdo vit akademik, fillimisht përpunohej nga departamenti përkatës,

¹³⁴ UET. "Format Suplementi MSH Mësuesi AM", ASCAL. Dok. nr.27.15.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹³⁵ UET. "Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore", ASCAL. Dok. nr.18.11. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹³⁶ UET. "Format Dosje Stafit Akademik", ASCAL. Dok. nr.133.44.1 dhe 134.44.2. Parë në Nëntor 2019, gjenden në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>më pas kalonte në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në përputhje me bazën ligjore në fuqi, neni nr.44 i Statutit të UET dhe Rregullorja e Burimeve Njerëzore përcaktojnë procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Përgjegjësi i Departamentit përcakton kriteret e punësimit të cilat miratohen nga Rektori (sipas Statutit), si edhe bën planifikimin e stafit akademik i cili sipas rregullores miratohet nga Dekani. Më pas bëhet shpallja e vendeve vakante dhe kriterëve përkatëse në media dhe në faqen e internetit të institucionit. Aplikimet i drejtohen Zyrës së Burimeve Njerëzore, e cila pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve në varësi të plotësimit të kriterëve, përgatit listën e kandidatëve që do të paraqiten për intervistë. Rektori ngre komisionin e rekrutimit, i cili sipas rregullores së rekrutimit përbëhet nga përfaqësues të rektoratit, dekanatit të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale dhe përgjegjësi i Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve si dhe ekspertë të fushës.</p> <p>Institucioni UET në paketën që ka paraqitur ka dhe dokumentacion bazë që rregullon veprimtarinë e Zyrës së Burimeve Njerëzore, parimet, kriteret, si edhe procedurat e punësimit.¹³⁷</p> <p>GVJ shqyrtoi dosjen e dy pedagogëve të këtij programi studimi të cilat përmbanin të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në “Listën e elementëve që përmban dosja e stafit akademik”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Rregullorja e Burimeve Njerëzore e hartuar në përputhje me statutin e UET përcakton procedura dhe kriterëve të posaçme për rekrutimin e personelit, të cilat bëhen publike nëpërmjet medias dhe faqes së internetit të institucionit.</p> <p>Institucioni aplikon praktika transparente¹³⁸ për procesin e punësimit të stafit qoftë me kohë të plotë qoftë me kohë të pjesshme, të gjitha këto në përputhje me bazën ligjore në fuqi¹³⁹.</p>

¹³⁷ UET. “Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore”, ASCAL. Dok. nr.18.11. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹³⁸ Faqja zyrtare e UET <http://uet.edu.al/neë/thirrje-aktuale-per-punesim/>

¹³⁹ UET. “Shembull thirrje për staf akademik”, ASCAL. Dok. nr.19.11.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Në dokumentacionin e brendshëm rregullator të institucionit¹⁴⁰ janë të përcaktuara qartë stadet e vlerësimit paraprak si edhe ato në vazhdim për stafin akademik.</p> <p>Kjo realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës¹⁴¹. Marrja e vendimeve për personelin, diktohet si nga mungesat që mund të vijnë në stafin e brendshëm ashtu dhe nga analiza e ngarkesës mësimore që krijohet për çdo vit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plot</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua që mjediset e punës ishin të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit. Institucioni kishte vënë të gjithë kapacitetet infrastrukture¹⁴² në funksion të plotë të krijimit të kushteve të duhura.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni aplikon politika nxitëse në drejtim të kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik¹⁴³.</p> <p>Këto përkthehen në zhvillimin e konferencave shkencore, botimet e revistave shkencore¹⁴⁴, përfshirjen në një numër të konsiderueshëm projektesh¹⁴⁵, ndërtimin e skemave të financimit për stafin për lehtësimin e praktikave botuese në revistat shkencore të indeksuara, etj</p>

¹⁴⁰ UET. “Rregullore e UET, Neni 22”, ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴¹ UET. “Rregullore e Universitetit European të Tiranës”, ASCAL. Dok. nr.8.5. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore”, ASCAL. Dok. nr.18.11. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴² UET. “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit”, ASCAL. Dok. nr.128.42. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴³ UET. “Të dhëna mbi shkëmbimin e stafit”, ASCAL. Dok. nr.131.43.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴⁴ UET. “Publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit”, ASCAL. Dok. nr.129.43. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴⁵ UET. “Projekte UET 2011-2018”, ASCAL. Dok. nr.132.43.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Ndër të tjera, për rritjen e kapaciteteve të stafit, Institucioni ka funksionale “Qëndrën e Metodologjisë dhe Kërkimit”, e cila ofron trajnime 1 ditore të grupuara sipas kualifikimeve të stafit akademik. Gjithashtu, Zyra e TIK, organizon trajnime të herëpashershme në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies¹⁴⁶.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Nga gjithë sa janë dokumentuar më sipër sa i përket angazhimit të burimeve njerëzore, Institucioni dëshmon menaxhimin më të mirë të mundshëm të burimeve njerëzore, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni ka mjediset e mjaftueshme të organizuar në salla leksionesh dhe në salla seminaresh për zhvillimin e veprimtarive të mësimdhënies teorike, në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Gjithsej janë funksionale 10 salla leksionesh me sipërfaqje totale 1.510m² dhe me 1515 ulëse. Salla seminaresh janë gjithsej 14 me sipërfaqe 45m² dhe secila me 35 ulëse. Gjithashtu, janë edhe 9 salla me nga 70 ulëse që mund të përdoren si për leksionet ashtu dhe për seminarët, secila me nga 100m² secila¹⁴⁷.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjediset të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua që mjediset mësimore si klasat e leksioneve dhe të seminareve, laboratorët e informatikës, ishin të pajisura me mjetet e duhura që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik, përmes përdorimit të metodologjive dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit.</p>

¹⁴⁶ “Trajnim mbi sistemin UET LMS”, ASCAL. Dok. nr.130.43.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴⁷ UET. “RVB, Master i Shencave, Mësuesi për Arsimin e Mesëm, faqe 42”, ASCAL. Dok. nr.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Specifika e programit Master i Shkencave në “<i>Mësuesi për Arsimin e Mesëm me profile</i>”, ka në fokus profilizimin e studentëve në 7 profile, të cilat janë: Gjuhë dhe Komunikim, Shkencat e Natyrës, Matematikë, Shoqëri dhe Mjedis, Teknologji dhe TIK, Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndet, si edhe Arte.</p> <p>Për të realizuar më mirë formimin shkencor të studentëve në këto profile, <i>sugjerojmë që duhet të ketë reflektime në kurrikulën e programit për këtë element në mënyrë që të përfshihet në program edhe zhvillimi i mësimin në laboratorë, studio apo atelie.</i></p> <p>Siç u konstatua edhe nga vizita në institucion, të gjitha sallat e leksioneve ishin të pajisura me mjete audiovizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit, me Sistemin Moodle, UET LMS¹⁴⁸.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në Institucion u konstatua që UET kishte katër laboratorë informatike, një nga të cilët ishte në mënyrë eksplicite në funksion të Lëndëve “Metoda Kërkimi të Avancuara dhe Metoda Kërkimore Sasiore” të programit të studimit Master i Shkencave “<i>Mësuesi për Arsimin e Mesëm</i>”.</p> <p>Në të gjitha PC ishte i instaluar programi SPPS, varinti 21, i domosdoshëm për zhvillimin e metodave kërkimore sasiore.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Vetë institucioni UET ka siguruar infrastrukturën e duhur për zhvillimin normal të praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Gjithashtu, dëshmuar edhe nga paketa e dokumentacionit që UET ka paraqitur si edhe nga bisedat me studentët e këtij programi, UET bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera¹⁴⁹ për kryerjen e praktikave profesionale.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Në Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

¹⁴⁸ UET. “Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS”, ASCAL. Dok. nr.146.46.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “UET-LMS Guidë për pedagogun”, ASCAL. Dok. nr.147.46.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “UET LMS Guidë për studentët”, ASCAL. Dok. nr.148.46.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁴⁹ UET. “Tabela përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale”, ASCAL. Dok. nr.91.32. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “Marrëveshjet e bashkëpunimit ; Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale”, ASCAL. Dok. nr.93.32.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

standardit	parafundësit	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në Institucion u konstatua që, për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, Institucioni kishte një bibliotekë të vendosur në një hapësirë me dritë natyrale. Biblioteka kishte rreth 150 vende ulëse leximi dhe funksionale me 12 PC të vëna në dispozicion të studentëve.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka kishte rreth 180 tituj të cilët ishin në fushën e edukimit, nga të cilët 120 janë në gjuhën shqipe dhe 60 janë në gjuhë të huaj, të gjitha në shërbim të procesit mësimor ¹⁵⁰ . Nga hulumtimi i titujve të vëna në dispozicion në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, konstatohet që kjo është një literaturë e mjaftueshme dhe relativisht e përshtatshme për mbulimin e moduleve e veprimtarive mësimore, duke ju përshtatur programit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e UET ishte e abonuar dhe në librarinë elektronike Sage & Ebsco dhe Questia dhe aksesit në këto platforma ishte pa pagesë për studentët.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka UET ka funksionale 12 PC të vëna në dispozicion të studentëve. Të gjitha PC ishin të pajisur me softëare-t përkatës, ku sistemet e operimit ishin Ëindoës 7, me paketën e plotë Microsoft Office ¹⁵¹ . Gjithashtu, Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBBIS.net, një rrjet ku përfshihen të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, ku mundësohet lidhja e bibliotekave në sistemin e informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën e katalogut të

¹⁵⁰ UET. "Dokumenti E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë", ASCAL. Dok. nr.138.45.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. "Inventari i teksteve në Edukim; Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës", ASCAL. Dok. nr.135.45. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁵¹ ASCAL. "Dokumenti i vizitës në Institucion data 4,5 dhe 6 Nëntor 2019".

	përbashkët dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse. Biblioteka kishte të siguruar akses në disa burime ndërkombëtare elektronike si Questia apo Social Science Library dhe në disa revista shkencore të huaja të tilla si Educational Leadership, etj.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga dokumentacioni u konstatua që pasurimi i fondit të bibliotekës ishte një proces i vazhdueshëm dhe i rëndësishëm i institucionit. Institucioni kishte axhendë të dedikuar për këtë qëllim. ¹⁵²			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Nga vizita në institucion, u konstatua që biblioteka kishte të afishuar në një vënd të dukshëm orarin të përshtatur dhe sipas nevojave të studentëve si gjatë zhvillimit të procesit mësimor, ashtu dhe gjatë sesioneve të provimeve, ku biblioteka funksiononte me orar të zgjatur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon sistemin UMIS ¹⁵³ , nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe me gjithë aktivitetin e tyre. Ky sistem është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, të dhënave akademike, realizimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Lidhur me studentët, UMIS përmban informacionin personal të studentit që nga regjistrimi i tyre, vlerësimin me nota dhe deri në diplomimin e tyre.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron	Nga vizita në Institucion dhe nga dokumentacioni i

¹⁵² UET. "E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë", ASCAL. Dok. nr.138.45.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. "Dokumenti E.IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës", ASCAL. Dok. nr.137.45.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁵³ UET. "Manual i përdoruesit të sistemit UMIS", ASCAL. Dok. nr.145.46. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>dorëzuar, u konstatua që UET, që nga viti 2016-2017 kishte funksional një sistem operimi Moodle (UET LMS)¹⁵⁴. Ky sistem administron edhe informacionin lidhur me lëndët që jep personeli akademik për çdo semestër dhe është i aksesueshëm nga sekretaria dhe studentët. Ndërsa komunikimi i personelit akademik me studentët lidhur me materialet mësimore dhe vlerësimin e studentëve bëhet nëpërmjet platformës LMS të UET.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i operimit Moodle (UET LMS), bën të mundur aksesimin e dedikur me anë të llogarive personale për studentët në kohë reale, të gjithë informacioneve të duhura për lëndën dhe gjithë detyrimet e akademike të lidhura me të¹⁵⁵. Gjithshtu, ky sistem ju mundëson pedagogëve auditim të plotë të të gjithë aktivitetit të tyre akademik. Pë më tepër, ky sistem shërben edhe si sistem njoftimesh.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua që platforma UET LMS është një platformë që mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe të shkëmbimit të informacionit nëpërmjet personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma LMS është një mjet që përdoret edhe nga Komisioni i Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë, pasi me anë të tij mund të monitorohet dhe mbarëvajtja e të gjithë procesit akademik. Ky sistem mundëson që drejtuesit dhe titullarët e institucionit të monitorojnë në kohë reale aktivitetin akademik dhe administrativ nëpërmjet raporteve statistikore që sigurohen nga sistemi në fund të çdo semestri.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Institucioni ka faqen e tij zyrtare në të cilën shfaqet i gjithë informacioni që ka lidhje me këtë institucion, duke filluar që nga gjithë dokuentacioni mbi programet, deri tek filozofia, misioni dhe qëllimi i insitucionit. Faqja është funksionale vetëm në gjuhën shqipe.¹⁵⁶</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Naë Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

¹⁵⁴ UET. "Mbi platformën LMS", ASCAL. Dok. nr.146.46.1, 147.46.2, 148.46.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁵⁵ Ibid

¹⁵⁶ Faqja Zyrtare e UET. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: eëë.uet.edu.al; "Dokumenti pika E.V. Mbi politikat e prezantimit/promovimit të UET on – line", ASCAL. Dok. nr.141.48. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

standardit	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Burimi kryesor i financimit janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit, ndërsa një kontribut tjetër lidhet me aktivitetet tregtare (qeradhënie, parkim etj.) Specifike për vitet e fundit 2013-2018 është edhe kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj ku UET është pjesëmarrës¹⁵⁷.</p> <p>UET-i ka të dokumentuara raportet financiare për vitin akademik 2017-2018. Të dhënat për vitin akademik 2018-2019 do gjenerohen të plota mbas mbylljes së bilancit vjetor.¹⁵⁸</p> <p>UET harton për çdo vit akademik një raport financiar që përmban të gjithë zërat financiare të të ardhurave si edhe ndarjen e burimeve financiare sipas zërave të buxhetit. Institucioni realizon një audit të përvitshëm, nga një kontabël i miratuar, raportet e të cilit janë të hartuara sipas standardeve përkatës.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në</p>	<p>Plani financiar është i hartuar në nivel institucional deri për vitin akademik 2017-2018, ku janë të përfshira të gjitha kostot dhe të ardhurat¹⁵⁹. Duke qënë se stafi është i angazhuar dhe në programe të tjera studimi nuk ka një raport të dedikuar vetëm për programin e studimit Master i Shkencave “<i>Mësuesi për Arsimin e Mesëm</i>”</p>

¹⁵⁷ UET. “*Të dhëna mbi koston për student*”, ASCAL. Dok. nr.142.49. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. “*Të ardhura dhe financime të ndryshme*”, ASCAL. Dok. nr.143.50. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁵⁸ Ibid

¹⁵⁹ UET. “*Të ardhura dhe financime të ndryshme*”, ASCAL. Dok. nr.143.50. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

<p>bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB, UET kryen auditim të pasqyrave financiare të përvitshëm, nga një kontabël i miratuar, raportet e të cilit janë të hartuara sipas standardeve përkatës.</p> <p>Raporti i auditit nga kompania “Deloitte ALBANIA”. E.E.I paraqet të gjitha zërat sipas formatit të kërkuar.</p> <p>Lidhur me pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sipas RVB, UET ka raport auditit çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Nga këto të dhëna, situata e deritanishme financiare dëshmon se UET ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi si edhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të vijuar veprimtarinë në vijim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga vizita në institucion si dhe shqyrtimi i dokumentacionit konfirmojmë se institucioni operon me procedura të mirëstrukturuara në funksion të studentit dhe në përmbushje të politikave dhe konform legjislacionit në fuqi. Procedurat përmbushen referuar rregullores së brendshme. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online ¹⁶⁰ , në broshurën informuese (Guida UET)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Konfirmojmë se procedurat nga hyrja në dalje të studentëve përmbushen në respekt të drejtave të secilit dhe në frymën e barazisë gjinore. Procedurat janë të parashikuara në rregulloren e programit, janë paraprakisht të njohura nga çdo student dhe monitorohen nga zyra e këshillimit dhe karrierës dhe të dokumentuar eloktonkisht dhe fizikisht në zyrat respective.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në vizitën në institucion dhe shqyrtimin e dokumentacionit konstatojmë, se pranimi, përzgjedhja dhe transeferimi i studentëve në program merr në konsideratë ciklin e studimeve të mëparshme të secit student dhe potencon ndjekjen e studimeve në programin respektiv. Të gjitha procedurat janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga të interesuarit. Kriteret e pranimit janë të aksesueshme online, dhe gjenden në aktet rregullatore në intranetin e UET ¹⁶¹ .
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Institucioni publikon kriteret e pranimit të studentëve që pritet të përfshihen në ciklin e dytë të studimeve.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në	Në fillim të vitit akademik, të intresuarit për ndjekje të ciklit të dytë të studimeve gjejnë të specifikuar kriteret dhe udhëzimet për pranimin.

¹⁶⁰<http://uet.edu.al/neë/si-te-aplikojme/>

¹⁶¹Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28); UET "Rregullore e zyrës së këshillimit dhe karrierës", ASCAL. Dok. nr.20.12. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS të ASCAL. Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik (Ref. Nr. 27.2); UET. "Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 5.3.3", ASCAL. Dok. nr. . Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS të ASCAL.

lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Bazuar në dokumentin “Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit te studenteve në UET” (Dok Nr. 39), institucioni njuh dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e programit të studimit si nëpërmjet faqes zyrtare online edhe nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale, apo mediave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	E konfirmojmë se Institucioni ofron informacion për kriteret e procedurat e pranimit si dhe procedurat specifike të kalimit nga një vit akademik në tjetrin ¹⁶² . Rregullorja e programit të studimit të Msc në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, pikat 5 dhe 6, vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni informon studentët në hyrje të studimeve dhe përgjatë procesit akademik rreth kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me Departamentin informojnë për vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për të transferuar studimet.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Konfirmojmë që: Institucioni operon me dokumentë të brendshëm sic është rregudhorja e programit ku specifikisht listohen procedurat e vlerësimit të secilit student. Në rregullore parashikohen dhe formati ‘tip’ vlerësimi referuar: dijes teorike, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave për cdo disiplinë pjesë e programit. ¹⁶³

¹⁶² UET. “RVB, Master i Shencave, Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, ASCAL. Dok. nr.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁶³ UET. “Rregullore e programit të studimit MSH, Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Konfirmojmë që: Institucioni njih cdo student me kriteret dhe procedurat që ndiqen deri në përmbushjen e diplomës ose provimit përfundimtar. ¹⁶⁴			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni organizon një strategji të qëllimtë, quajtur “gjimnastur” përgjatë së cilës stafi akademik, organizon takime të hapura ku njih studentët potencialë dhe të interesuar, me programin në fjalë dhe epërsitë e këtij programi. (Referuar bashkebisedimeve me z/Rektoren e institucionit). Për punimin e diplomës, ka plan të detajuar që nga miratimi i temës pedagogun udhëheqës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimi dhe mbrojtja. ¹⁶⁵			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen hollësisht për strukturën, kohështrirjen, planin mësimor deri tek syllabuset për cdo vit akademik si dhe përthyerjen e tyre në ECTS. Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Këshillimit në momentin që interesohen për programet e studimit; • Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit; • Rregullores mësimore të programit të studimit; Kontratës që nënshkruhet me UET në momentin e regjistrimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet,	Konfirmojmë që cdo student ka dijeni të detajuar për cdo disiplinë, modulet specifike, praktikën profesionale dhe detyrimet për shlyerjen e cdo syllabusi. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në

¹⁶⁴ Ibid

¹⁶⁵ UET. “Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”, ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	dispozicion programi i të gjitha lëndëve, ngarkesa, për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme, e rekomanduar për secilën temë, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura. Studentet kanë akses mbi ngarkesat, nëpërmjet LMS. Për studentët e vitit të dytë, marrin sërish informacion në momentin e përzgjedhjes së lëndës, nga pedagogu përgjegjës për këtë proces. ¹⁶⁶			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjatë bisedës së orientuar dhe të qëllimtë me grupet studentëve si dhe me pedagogët që përmbushin programin, konstatojmë, se studentët marrin një informacion më të hollësishëm rreth tregut të punës. Kjo përmbushet specifikisht në veprimtarinë që organizon institucioni “ditët e panairit të punës” por jo vetëm. Organizimi i panairëve të punës dhe aktiviteteve me aktorë nga tregu i punës; ¹⁶⁷ nuk na rezultojnë të pasur impakt në programin në fjalë.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga bashkëbiseda e qëllimtë me studentët dhe shqyrtimi i dokumentacionit pranojmë se programi ofron mundësi për të përditësuar proceset e mësimdhënies. Gjithashtu i gjithë informacioni lidhur me zhvillimin e procesit mësimor (orari mësimor, plani mësimor, ndryshimet e orarit) u komunikohen studentëve nga koordinatori i programit të studimit nëpërmjet publikimit të informacionit në këndin e njoftimeve dhe/ose online, nëpërmjet komunikimit me e-mail dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit LMS.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	E konfirmojmë që informacioni rreth ecurisë dhe të dhënave të programit në fjalë është në system elektronik dhe fizik, dhe lehtësisht i arritshëm për studentët. Sistemi LMS, lehtëson studentët edhe pse mund të jenë në distancë, të marrin njoftimet nga pedagogu i lëndës, orarin mësimor të personalizuar; njoftimet mundësi komunikimi me mesazhe, <i>chat</i> -e me pedagogët etj.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Konfirmojmë se programi ka një menaxhim të brendshëm i cili mirëadministrohet dhe vihet në funksion të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁶⁶UET. “Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 5.3.3”, ASCAL. Dok. nr. . Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁶⁷Poster_Panairi i punës 2019 (Ref. Nr. 12.2); Dita e Humaniteteve në UET; <http://uet.edu.al/në/punimet-e-studenteve-ne-uet-perballja-e-pare-me-tregun-e-punes/>

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatuam se institucioni ka statistika të detajuara për studentët dhe të diplomuarit në programin respektiv. Të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për secilin program studimi.</p> <p>Sipas dokumentacionit të depozituar nga institucioni¹⁶⁸ dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2017-2018 sipas profileve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edukim fizik, sporte dhe shëndeti: 1 student; - Matematikë 1 student; - Administrim shkollor 2 studentë; - Politikat e edukimit 1 student; - Totali 5 studentë <p><i>Për këtë vit akademik rezulton se pesë profile nuk kanë studentë. (dy nga profilet janë të programit në kuadër të licensimit).</i></p> <p>Viti 2018-2019 sipas profileve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edukim fizik, sporte dhe shëndeti: 8 studentë; - Matematikë 4 studentë; - Arte 2 studentë; - Gjuhët dhe komunikimi 5 studentë; - Shkencat e natyrës 1 studentë; - Shoqëria dhe mjedisi 2 studentë; - Teknologjia dhe TIK 2 studentë; - Totali 24 studentë <p>Viti 2019-2020 sipas profileve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edukim fizik, sporte dhe shëndeti: 4 studentë; - Matematikë 3 studentë; - Arte 4 studentë; - Gjuhët dhe komunikimi 10 studentë; - Shkencat e natyrës 1 studentë; - Shoqëria dhe mjedisi 3 studentë; - Teknologjia dhe TIK 1 studentë - Totali 26 studentë <p>Për sa i përket numrit të të diplomuarve në këtë program</p>

¹⁶⁸ UET. “-Cilesia ne hyrje dhe dalje e studenteve te programit, Msc. Mësuesi për Arsimin e Mesëm), ASCAL. Dok. nr.85.27. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL. UET. “-Tabela përmbledhëse për punësimin real të studentëve”. ASCAL. Dok. nr.90.29. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

	studimi rezulton se: Për vitin akademik 2016-2017 janë diplomuar 13 studentë; Për vitin akademik 2017-2018 janë diplomuar 6 studentë;			
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Konstatuam se institucioni ka të dokumentuar cdo të regjistruar në programin në fjalë, tërheqet, largimet/konvertimet nga programi studimit. Sistemi UMIS mundëson që të dhënat statistikore të përpunohen në çdo kohë, nga viti i parë akademik kur UET ka nisur aktivitetin 2006-2007. Për programin Msc në Mësuesi për Arsimin e Mesëm, rezultoni në total 8 studentë të transferuar. Numri i studentëve të regjistruar në total për këtë vit akademik është 26 studentë .			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Konfirmojmë se ka të dhëna të detajuara dhe të dokumentuara për cdo student nga fillimi deri në përbushje të programit. Per cdo student ka dosje ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Te dhenat ruhen në sistemin elektronik dhe në regjistrat që plotësohen me shkrim. Ato gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve ¹⁶⁹ .			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga takimet konform agjendës së viztës me njësite brenda institucionit konstatuam se të dhënat statistikore për cdo student janë të sigurt në konfidencialitet të plotë dhe lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. UMIS, program informatik krijuar për ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, e statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Konstatuam të dhëna statistike dhe individuale për profilin e çdo studenti në hyrje, përfshirë dhe statusin: i punësuar/i papunësuar, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. ¹⁷⁰ , <i>por nuk prekëm analiza apo arsytetime specifike rreth cilësisë në hyrje ose indikatorë që masin përmirësimin gjatë procesit të shkollimit.</i>			
Shkalla e përbushjes së	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

¹⁶⁹Dokumenti E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9);

¹⁷⁰Analiza e departamentit për programin e studimit(Ref. Nr. 38)

standardit

X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.

Institucion zbaton përfshirjen e studentëve në struktura të përherëshme ose "AD-HOK", referuar detyrimeve ligjore si dhe rregullores së brendshme të institucionit. (referuar takimit me studentët si dhe referuar takimit me GVB ku studentët janë factor).

Konstatuam se inkurajohet pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre.¹⁷¹ Si:

- Këshilli i Studentëve
- Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve.
- Këshilli Etikës – një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.
- KSBC – një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.
- Mbledhjet e departamenteve, e hapur për studentët;
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Msc në "Mësuesi për arsimin e mesëm".

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Konstatojmë se studentët janë faktor me peshë në proceset e përbushjes së programit. Studentët janë aktivë në vlerësimin e cilësisë së stafit akademik. Mendimi i secilit tërhiqet përmes pyetësorëve që zhvillohen për çdo modul, konform një formati "tip" ku ruhet konfidencialiteti.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Nuk konstatuam të ketë ankimime për mbingarkesë nga ana e studentëve në përbushje të programit. Konstatuam se kishte njohje dhe ekujvalentim të studimeve praraprake të studentëve të përfshirë në program. Shpërndarja e lëndëve në semestra rezultojnë e balancuar.

Në vitin e parë studentët ndjekin 5 lëndë në semestër (me nga 30 ECTS secila).

Në vitin e dytë, semestrin e parë, studentët ndjekin 4 lëndë, si edhe nisin punën për shkrimin e punimit të diplomës, semestrin

¹⁷¹ Statuti UET, Neni 16, 19 dhe 51 (Ref. Nr. 2)

	e dytë, të vitit të dytë ndjekin 1 lëndë, duke qenë se i krijohen lehtësira për tu angazhuar në praktikën profesionale dhe për shkrimin e punimit të diplomës. Secili semestër ka ngarkesë 30 ECTS ¹⁷² .			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Referuar dokumentacionit si rregullorja e programit, institucioni lejon përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të programit dhe reflekton sygjerimet e tyre, por për programin në fjalë, <i>nuk patëm indikacione që na cojnë të konfirmojmë që studentët kanë qënë pjesëmarrës në riorganizmin e programit Diplomë në MSc Mësuesi me 7 profile.</i>			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Gjatë vizitës në institucion, por, dhe gjatë bashkëbisedës me studentët nuk identifikua raste kur procesi i kontrollit të dijeve të jetë ankimuar dhe të mos ketë marrë reflektimin nga ana e pedagogut. Sekretimi i provimeve, është i konfirmuar si parim, zhvillimi i seancave sqaruese nga pedagogu, mundësia për rivlerësim konfirmojmë se janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët mundësohen të parashtrajnë ankimimin duke plotësuar formularët respektivë ta parashikuar enkas. ¹⁷³			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Stafi akademik përfshihet në veprimtari në fushën e kërkimit shkencor brenda dhe në institucione si motra jashtë vendit. Institucioni është përfitues i projektit European IVIVA, project ku institucioni ka statusin e liderit. Në këtë kuadër, tre pedagogë të programit janë direkt përfitues. Stafi akademik është stimuluar për pjesëmarrje në veprimtari shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore, duke përfituar dhe mbështetje financiare. UET u ofron pedagogëve mundësinë për të publikuar në revistën ndërkombëtare shkencore POLIS dhe për të referuar

¹⁷² Plani mësimor i programit të studimit (Ref. Nr. 14.1)

¹⁷³ UET. "D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve". ASCAL. Dok. nr.126.40.1. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

	në konferencën ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”. Aktualisht janë rritur kërkesat në drejtim të cilësisë së punimeve duke kërkuar publikimeve në revista me faktorë impakti mundësisht Thomson Reuters/Clarivate Analytics dhe Scopus. ¹⁷⁴			
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me institucione brenda dhe jashtë vendit në fusha të ndryshme të veprimtarisë. Por institucioni nuk ka marrëveshje specifike që kanë fokus objektiva të mirëfillta që potencojnë direkt programin në fjalë.			
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Priremi të besojmë se stafi akademik i stimulon studentët në procese kërkimi, në fushat respektive në të cilat ata po diplomohen.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Nga vizita ne institucion dhe bashkëbiseda, priremi të besojmë se ka një fond të veçantë, prej 75.000 eurosh, për të nxitur stafin, për të kryer veprimtari kërkimore cilësore dhe të botojnë në revista me factor impakti, kryesisht, Thomson Reuters/Clarivate Analytics dhe Scopus. Institucioni mbështet publikimin e punimeve kërkimore në revistat shkencore ndërkombëtare që UET boton siç është revista “Polis”, për studime në shkencatsociale dhe humane.			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Referuar statutit dhe rregullores së institucionit studentët stimulohen drejtë studimeve innovative. Por, referuar programit në fjalë nuk konstatoam diçka konkrete në këtë aspekt.			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	E konstatoam që institucioni organizon seanca metodologjike që studenti të mirëorientohet gjatë proceseve rutinore kërkimore. Studenti/ja ka asistencën e nevojshme që në përcaktimin e temës deri në momentin e mbrojtjes. Pedagogu udhëheqës është garantues i cilësisë së punimit të kryer nga studenti, pasi ky i fundit, nuk futet në mbrojtjen e temës, nëse nuk është e firmosur nga udhëheqësi. ¹⁷⁵			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁷⁴UET. “*Strategjia e Kërkimit Shkencor në UET 2017-2020*”, ASCAL. Dok. nr.6.3.1 Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁷⁵UET. “*Dokumenti B.II, Mbi punimin e diplomës*”, ASCAL. Dok. nr.16.10. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

Standardi V.7**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Nuk konstatojmë konkretisht bashkëpunim me institucione kombëtare me të cilën ka pikëprerje dhe do ta bënte më të qëndrueshm programin në fjalë. <i>Një marrëveshje me ASCAP, (ish IZHA), institucion që përgatit kurrikulën kombëtare të arsimit parauniversitar do të ushqente e do ta bënte më të qëndrueshëm programin.</i>								
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Referuar planit, dhe sillabuseve konkrete veçanarisht në vitin e parë të programit MSc në Mësuesi për Arsimin e Mesëm, e vlerësojmë se ky program potencon studime të thelluara për ciklin e tretë.								
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Institucioni i ka të përcaktuara qartë politikat e përfshirjes së studiuesve të rinj, nëpër projektet kërkimore. Për të rritur cilësinë e kërkimit shkencor dhe ndër-disiplinaritetin, UET ka ndërtuar 11 Projekte Kërkimore (PMK), të cilat për bëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET. Këto projekte, drejtohen nga senior researchers dhe orientojnë punën kërkimore shkencore të Junior Researchers, në PMK-të ku bëjnë pjesë.								
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	E konfirmojmë se institucioni stimulon kërkimin shkencor dhe se në marrëveshjet ndërinstitucionale është pjesë e tyre.								
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Ndërkombëtarizimi dhe rritja e mobilitetit të studentëve, është në politikat e UET, i cili ndjek politika favorizuese duke lehtësuar procedurat e procesit të shkëmbimit të studentëve. <i>(Urdhër Administrativ, nr.22, datë 24.11.2016). Nuk e konfirmojmë konkretisht se ku po bëhen lehtësira për studentët ne programin në fjalë.</i>								
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	E konfirmojmë se institucioni stimulon kërkimin shkencor dhe se në marrëveshjet ndërinstitucionale është pjesë e tyre. Por, referuar programit në fjalë nuk konstatojmë student të huaj të kenë përfutur nga veprimtaritë e programit në periudha të caktuara.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.8**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë**

në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka zyrën e këshillimit dhe të karrierës, njësi e cila ka të qarta dhe procedurale punën me çdo student. Kjo zyrë apdejton çdo student me detyrimet dhe mundësitë që ofron program deri në përmbushje dhe me tej ¹⁷⁶ .
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka njësi që: informojnë, këshillojnë, orientojnë, ekujvalentojnë, identifikojnë çdo nevojë të studentëve që lidhet me arritjen e objektivave mësimore. Të gjitha këto mikroinstitucione përcjellin një sistem, që ndjek procesin individual të secilit nga mësimi në auditor deri tek praktikat dhe faën finale diplomimin. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Konstatuam së zyra për këshillim e studentëve punon në mënyrë permanente. Praktikrat profesionale më së shumti të vetë rregulluara nga studentët të cilët në mjaft raste i përmbushnin ato në institucionet ku punojnë. Ky fakt u konstatua jo vetëm nga bisedat me studentet, por u pranua dhe nga stafi akademik. Zyra e këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit. Zyra e karrierës organizohet me persona, të cilët kanë orare të shpallura të pritjes së studentëve. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra për këshillim ka institucionalisht detyrimin dhe disponon të dhëna për studentët pas përfundimit të programit të studimit. Ecuria e mëtejme e çdo studenti është një nga detyrimet që derivon nga rregullorja e programit.

¹⁷⁶ UET. "Rregullore e programit të studimit MSH, **Mësuesi për Arsimin e Mesëm**", ASCAL. Dok. nr.10.7. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Plotë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Konfirmojmë se SBC funksionon në përputhje të plotë të misionit të institucionit dhe në frymën e legjislacionit. KSBC si strukturë, është e paraparë në Statutin e UET me detyrime të qarta dhe të plota¹⁷⁷. Ky institucion ngre instrumente specifike në funksion të garantimit të cilësisë dhe monitoron cilësinë.</p> <p>E konfirmojmë se gjatë vizitës në institucion se SBC ndërton politika të përthyer në procedura duke ju referuar akteve ligjore.¹⁷⁸</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve <i>ad hoc</i>, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit¹⁷⁹.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e	SBC, krijon frymë bashkëpunimi mes strukturave të brendshme në institucion dhe garanton sinkronizim, informim, periodic për cdo veprimtari në funksion të cilësisë së programit. SBC tregon vëmendje të posaçme për përfshirje të studentëve në ruajtjen e cilësisë, si interesuari për cilësi dhe përmbushje të të drejtave, sic është student.

¹⁷⁷ UET. "Statuti i UET, neni 16.1", ASCAL. Dok. nr.4.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

¹⁷⁸ Ibid

¹⁷⁹ UET. "Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC", ASCAL. Dok. nr.101.30. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL., UET. "Urdhër Mbi përbërjen e KSBC", ASCAL. Dok. nr.105.30.4. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

ekspertë të jashtëm.									
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	KSBC përmbush me rigorozitet detyrimin për të garantuar vlerësimin e brendshëm, periodik dhe specifik deri tek angazhimi për të kërkuar ‘akreditimin’ e programeve brenda afatit ligjor. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të licensimit, të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Ky program është licensuar me Urdhër Nr. 408, datë 22.08.2011, dhe është akredituar me Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013. Ky vlerësim është në kuadër të akreditimit periodik.								
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	Gjatë bashkëbisedës së qëllim të me zyren e KSBC konstatoam se anëtarët, kanë njohje të detajuar të detyrës që kanë në institucion si dhe frymën e punës deri në nivelin e “kulturës” së punës. Veprimtarinë e saj KSBC-ja e mbështet në frymën dhe detyrimet që derivojnë nga dokumente strategjik ¹⁸⁰								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Institucioni, departamenti përkatës dhe kordinatori i programit monitoron ecurinë dhe identifikon nevojën për rishikim të programit respektiv. Ky process kryhet në mënyrë procedural dhe merr në konsideratë gjithë faktorët si: studentët dhe vlerësimet për programin, tregun e punës dhe risitë e identifikuar nga të tretët.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara	Departamenti është njësi bazë akademike që merr në shqyrtim nevojën për rishikim të programit nga plani deri tek syllabuset. Rishimi ndjek rrugën institucionale deri në vendimin akademik

¹⁸⁰ UET. “Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022”, ASCAL. Dok. nr.104.30.3. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL, UET. “Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”, ASCAL. Dok. nr.103.30.2. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	për ndryshimin e epërtimit të programit dhe formatimit të Diplomës, sic është dhe rasti në Programin që po analizojmë i cili sjell një program me 7 profile të reja në Mësuesi.			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Konstatuam se: Institucioni aplikon në parim dy instrumente bazë për të identifikuar ecurinë e programit: <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi nga jashtë sic janë mendimet që vijnë nga studentët; 2. Vetëvlerësimi që vjen nga stafi akademik, i cili në raste të caktuara, e shikon të nevojshme dhe shkon drejtë riformatimit të programit sic është rasti i programit në fjalë, MSc në Mësuesi me profile. 			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Konfirmojmë se rezultatet e vlerësimeve ju përcillen autoriteteve vendimmarrëse në institucion, konform rregullores së institucionit dhe ruhen apo perdoren si referenca për qëllime të caktuara. Rezultatet e dala nga matja, vlerësimi janë dokumentuar dhe janë bërë prezente te autoritetet vendimmarrëse akademike			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Rregullorja e programit parashikon detyrimin që rezultatet e vlerësimit të shërbejnë si pikë referimi për të adresuar problematikat tek aktorët faktike, konkrete dhe identifikuar kohën specifike që kërkon përmirësimi i rezultatit faktik. Nuk konstatuam një raport vlerësimi konkret.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	VB udhëhiqet, monitorohet, nga SBC, referuar formatit me të cilin operon dhe ASCAL për të bërë Vlerësimin e Jashtëm. Grupi është i përbërë nga staf akademik i programit dhe detyrimisht një student përfitues i programit. VB bëhet i njohur nga strukturat brenda institucionit dhe ky VB ushqehet nga zyrat që janë në funksion të përmbushjes së programit. VB është i aksesueshëm nga të intresuarit brenda institucionit. VB merr formën zyrtare në momentin kur dorëzohet në zyrat e ASCAL dhe kërkon akreditimin e programit sic është rasti në fjalë.

<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Konfirmojmë se” për përgatijen e VB janë aplikuar metodologji sasiore dhe cilësore deri në materialin përfundimtar.</p> <p>KSB, aplikon metoda si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teste të standardizuara; • Dëgjime në auditor; • Vlerësimi me pikë; • Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; • Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe asistime ne sallat e mesimit (Drejtuesi i departamentit/Dekani) . Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi¹⁸¹.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Konstatojmë se grupi i VB ka bërë focus të analizës objektivat e programit, metodologjinë e përdorur gjatë mësimdhënjes, kurrikulat, sylabuset, përthyerjen në leksione/ushtrime/punë në auditor/punë individuale.</p> <p>E gjithë procedura është bërë përmes instrumenteve si: vëzhgimi, matja, frekuenca etj.</p> <p>Nuk konstatoam krahasimin me programe të ngjashme, organizuar nga institucione si motra, sic është programi në fjalë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe në bashkëbisedat e qëllimta konform agjendës së vizitës, konfirmojmë se: vlerësimi programit bëhet periodik. Aplikohen metodologji mix për të identifikuar në thellësi problematikat por dhe arrijtet. Organizohen metodologji si ‘fokus grup’ apo intervista prekin si studentët e përfshirë në program po ashtu studentët që kanë përfunduar studimet.</p>

¹⁸¹ UET. “G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu”, ASCAL. Dok. nr.109.30.8. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë bisedes me grupin e SCB dhe shqyrtimit të dokumentacionit priremi të besojmë se: në funksion të garantimit permament të cilësisë së programit janë të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Në funksion të këtij qëllimi ka bashkerendim të proceseve dhe procedurave që garantojnë cilësinë e programit.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Konfirmojmë se në funksion të cilësisë ka detyrime dhe përgjegjesi konkrete institucionale cdo njësi: departamenti, kordinatori i programit, zyra e karrieres, sekretaria mësimore, stafi akademik. Sinkronizimin e veprimtarisë së secilës njësi e garanton KSBC.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Referuar rregullores së programit, cdo njësi ka detyrimet e veta institucionale për garantimin e cilësisë në kohë, përfshirë këtu stafin akademik dhe studentët përfitues.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë	Konfirmojmë se vlerësimi i brendshëm i pjesëshëm apo tërësor funksionon mbi parime etike të konfidencialitetit dhe eviton pabarazinë apo diskriminimin, qoftë kur vlerësohet puna e studentit, qoftë kur vlerësohet performanca e stafit akademik. konfirmojmë se: personat që përfshihen ne proceset e vlerësimit gëzojnë respektin për:

çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<ul style="list-style-type: none"> • Kompetencat profesionale; • Paanshmëria; • Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe <p>Kriteri i detyrueshëm mbetet, të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.</p>								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Konfirmojmë se pjesë e proceseve të vlerësimit në funksion të garantimit të cilësisë janë dhe stafi akademik i jashtëm. Kjo e paraparë në rregulloren e brendshme.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Çdo veprimtari e inicuar nga KSBC është publike për studentët dhe të interesuarit. Veprimtaritë në funksion të garantimit të cilësisë janë detyrim që derivon nga statuti dhe rregullorja e institucionit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Cdo rezultat i vlerësimit për segmente të caktuara që lidhen me programin bëhen publike dhe janë në respekt të plotë të të dhënave personale konform legjislacionit. Rezultatet e vlerësimit nuk mund të keqpërdoren për qëllime të caktuara pasi ato janë pjesë e garantimit të drejtave individuale dhe institucionale. Ato përdoren vetëm për qëllime të caktuara në funksion të përmirësimit të cilësisë apo si system referimi, dhe vetëm me leje nga strukturat brenda institucionit.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e	Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen në mbështetje të procesit të follow-up-it, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit lëpset të

mangësive e dobësive të evidentuara.	bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik ¹⁸² . Nuk konstatoam se ka një plan masash ku adresohen përmirësime specifike apo gjeneraliste të programit MSc në Mësuesi.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Priremi të besojmë se efektiviteti, impakti, monitorimi që vjen nga KSCB, në funksion të praktikave mësimore të studentëve të përfshirë në program nuk është në nivelet më të larta.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Zyra e KSCB monitoron periodikisht veprimtaritë në funksion të cilësisë dhe projektton instrumente, përgjithësisht për të ndërgjegjësuar përmirësime afatgjata që lidhen me cilësinë e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Mësuesi për Arsimin e Mesëm”, me profile: a. Gjuhët dhe Komunikimi, b. Shkencat e Natyrës, c. Matematikë, d. Shoqëria dhe Mjedisi, e. Teknologjia dhe TIK, f. Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti, g. Arte”, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

a. Pikat e forta dhe afirmime

1. Konfirmojmë se Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Arsimin e Mesëm” me 7 profile, është hartuar në frymën dhe në përmbushje të plotë me kërkesat e ligjit;

¹⁸² UET. “G-I-12-1 Formulari i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik”, ASCAL. Dok. nr.127.41. Parë në Nëntor 2019, gjendet në: Sistemin AMS te ASCAL.

2. Programi Master i Shkencave në “Mësuesi në Arsimin e Mesëm” me 7 profile, ka ekuilibrin e nevojshëm ndërdisiplinar, i referohet kurrikulës zyrtare mbi të cilën funksionojnë dy ciklet e arsimit AMU dhe AML në sistemin e arsimit parauniversitar në vendin tone;
3. Programi Master i Shkencave në “Mësuesi në Arsimin e Mesëm” me 7 profile, potencon fuqishëm formimin pedagogjik të studentëve;
4. Staf i akademik i brendshëm dhe i jashtëm e mbulon programin me kompetencë pasi, pedagogët gëzojnë titujt dhe gradat akademike në përmbushje të detyrimeve ligjore;
5. Programi Master i Shkencave në “Mësuesi në Arsimin e Mesëm” me 7 profile, potencon të interesuarit për vazhdimin e studimeve në nivelin e tretë në fushën e shkencave të edukimit për shkak se operon mbi një repertor të gjerë disiplinash;
6. Programi funksionon në harmoni për shkak se jeta në institucion është e rregulluar përmes statutit dhe rregullores;
7. Format e vlerësimit përgjatë programit janë të sofistikuar. Ato operojnë në rrafshin: vertikal, horizontal e periodike, mbështetur në indikatorë të aksesueshme dhe të dokumentuara;
8. Programi LMS është pikë e fortë që lehtëson ecurinë e programit;

b. Pika të dobta

1. Konstatohet se formimi shkencor për profilet respektive si: gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, matematika, shoqëria dhe mjedisi, teknologjia dhe TIK, edukimi fizik, sportet dhe shëndeti, dhe Artet, vjen relativisht i pakët;
2. Programi Master i Shkencave në Mësuesi me 7 profile, nuk mbështetet me laboratore {specifikisht në profilin e shkencat e natyrës} dhe me atelje {në profilin arte} apo mjedise sportive në profilin {edukim fizik dhe shëndeti}, gjë që do ta potenconte shumë zhvillimin e kompetencave referuar profileve specifike;
3. Praktika profesionale: Rezulton se përmbushja e praktikave profesionale të studentëve në institucione që aktualisht zhvillohet, nuk e justifikon praktikën profesionale të një studenti që diplomohet në AM me profil mësuesi në matematikë/shkenca sociale e tjera, gjithashtu, mungon dhe sistemi i mentorëve të certifikuar nga institucioni;

Rekomandime:

1. Rekomandojmë të ketë reflektime në kurrikulën e programit për dy aspekte të rëndësishme të formimit shkencor të studentëve:
 - a) Rifformatim i sylabuseve brenda të mundshmes dhe të domosdoshmes me formimin shkencor që ushqen diplomën në profilin respektiv;
 - b) Përfshirje në programin e studimit edhe zhvillimi i mësimit në laboratorë, studio apo atelie;
2. Rekomandojmë përmbushjen e praktikave profesionale të studentëve në institucione që janë në resonancë me qëllimin dhe objektivat e programit të studimit, dhe ngritjen e Sistemit të mentorëve të certifikuar nga institucioni për praktikat profesionale;

Conclusions of the Evaluation Process of the study program “Master of Science in: Teacher for Higher Education with profiles: a. Languages and Communication, b. Nature Sciences, c. Mathematics, d. Society and the Environment, e. Technology and ICT, p. Physical Education, Sports and Health, g. Arts

a. Strengths

1. It is confirmed that the Master's Degree Program in Teacher of Secondary Education with seven profiles is designed in the spirit and full compliance with the requirements of the law;
2. The study program “Master of Science in Teacher of Secondary Education” with seven profiles, has the necessary interdisciplinary balance, refers to the official curriculum on which the two cycles of LSE (Lower Secondary Education, 6th to the 9th grade) and HSE (Higher Secondary Education, 10th to the 12th grade) operate in the pre-university education system in Albania;
3. The Master of Science Program in Teacher in Secondary Education with seven profiles strongly emphasizes the formation of students in pedagogical sciences;
4. Full time and part-time academic staff cover the program competently as lecturers enjoy academic freedom degrees and degrees in fulfillment of legal obligations;
5. Master of Science Program in Teacher in Secondary Education with seven profiles, emphasizes the interest for further studies at the third level in the field of education sciences because it operates on a wide range of disciplines;
6. The program operates in harmony because life in the institution is regulated by statute and regulations;
7. The forms of evaluation throughout the program are sophisticated. They operate in the vertical, horizontal and periodic plains, based on accessible and documented indicators;
8. LMS program is a strength, that facilitates study program performance;

b. Weaknesses

1. Scientific preparation for the respective profiles such as languages and communication, natural sciences, mathematics, society and environment, technology and ICT, physical education, sports and health, and the arts, comes relatively scarce;
2. Teacher Science Master Program with seven profiles, not supported by laboratories {specifically in the profile of the natural science} and ateliers {in the arts profile} or sports environments in the {physical education and health} profile, which would greatly emphasize the development of students’ competencies referring to specific profiles;
3. Experiential Learning: It turns out that fulfilling the internships in the institutions that are currently taking place, does not justify the experiential learning of a student graduating in the LSE or HSE cycle with a profile in mathematics / or social sciences teacher. The system of mentors certified by the institution is also;

Recommendations:

1. It is recommended reflection on the curriculum of the program for two important aspects of student scientific preparation:
 - a) Reformulation of the syllabuses within the possible and indispensable with the scientific preparation that nurtures the diploma in the respective profile;
 - b) Inclusion of the hours in the study program such as laboratories, studios or ateliers;
2. It is recommended the fulfillment of students' experiential learning in institutions that resonate with the purpose and objectives of the study program, and the establishment of a certified mentoring system for internships;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT EVLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Marjana SINANI

Dr. Leticja GUSHO